



## **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

### **MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEÇ**

**TIRANË, KORRIK 2022**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

**PËRMBAJTJA:**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3-8</b>
<b>I.a</b>	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
<b>I.b</b>	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	3-5
<b>I.c</b>	Opinion i auditimit	5-8
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>8-11</b>
<b>1</b>	Objektivat dhe qëllimi	8-9
<b>2</b>	Identifikimi i çështjes	9-9
<b>3</b>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
<b>4</b>	Përgjegjësitë e audituesve	9-9
<b>5</b>	Kriteret e vlerësimit	9-10
<b>6</b>	Standardet e auditimit	10-11
<b>7</b>	Metodat e auditimit	11-11
<b>8</b>	Dokumentimi i auditimit	11-11
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>12-64</b>
<b>III.1</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim</b>	<b>12-12</b>
<b>III.2</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit</b>	<b>13-64</b>
<b>III.2.1</b>	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	13-23
<b>III.2.2</b>	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar; ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2020 dhe 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.	23-50
<b>III.2.3</b>	Vlerësimi Raportimit Financiar, <u>për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë</u> , bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeö i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.	50-62
<b>III.2.4</b>	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	63-64
<b>IV</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>64-73</b>
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>73-82</b>



## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òMbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Pogradec, në bazë të Programit të Auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 374/1, datë 08.04.2022, me afat auditimi deri në datën 20.05.2022, për auditimin financiar në Bashkinë Pogradec. Projektraporti i Auditimit u hartua bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, Akt Verifikimet, vërejtjet e bëra nga subjekti òBashkia Pogradecò, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 374/6, datë 16.06.2022, si dhe është konfirmuar njohja dhe janë dërguar objeksionet nga subjekti i audituar, me shkresat përcjellëse nr. 374/6 dhe 374/7, datë 27.06.2022, si dhe 374/8, datë 04.07.2022.

### I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave vendore, u konstatua se, Sektori i Taksave Vendore, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatohet se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.</p> <p>Këto veprime kanë çuar në mos planifikim të taksës së tokës, për shumën 3,084,700 lekë, e cila është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.</p>	Pika III.2.2 Faqe 23-50	I lartë	Sektori i Taksave Vendore i Bashkisë Pogradec, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të bujqësisë, përfshirjen në planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore të shumës 3,084,700 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.
2	<p>Nga auditimi mbi pajisjen me leje tregtimi të subjekteve që operojnë në fushën e hidrokarbureve u konstatua se, subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektsh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Pogradec, nuk është aplikuar tarifa për</p>	Pika III.2.2 Faqe 23-50	I lartë	Sektori i Taksave Vendore i Bashkisë Pogradec, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 9,600,000 lekë, për 9 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

	pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 9,600,000 lekë, vlerëe cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Pogradec.			
3	Nga auditimi mbi të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e aseteve u konstatua se, Sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën objekt auditimi administrohen 41 kontrata qiraje për objekte dhe troje. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e objekteve dhe trojeve, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se për 11 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 22,798,289 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec. Nga Sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës, me subjektet të cilët kanë marrë me qira objekte dhe hapësira publike, veprim në papajtueshmëri me germenin 08/07/2010, neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura për objekte dhe troje të marra me qira.	Pika III.2.2 Faqe 23-50	I lartë	Nga Titullari i Bashkisë Pogradec, Sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, si dhe Njëpunësi zbatues, për 11 subjektet debitorë të krijuar si pasojë e shkeljes së detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, të merren masa për të ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore nga arkëtimi i detyrimeve në shumën totale 22,798,289 lekë deri në zgjidhjen e kontratës.
4	Nga auditimi mbisubjektet debitorë dhe vlerën e detyrimeve të krijuar prej tyre, referuar të dhënave të Bashkisë Pogradec rezulton se, më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Pogradec, në vlerën gjithsej 59,397,820 lekë, janë debitorë respektivisht subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej 339 subjekte në vlerën 26,359,607 lekë; 6,040 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 30,511,503 lekë dhe debitorë nga toka bujqësore 4,915 familje në vlerën 2,526,710 lekë.	Pika III.2.2 Faqe 23-50	I lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore i Bashkisë Pogradec të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 339 subjekte në vlerën 26,359,607 lekë; 6,040 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 30,511,504 lekë dhe debitorë nga toka bujqësore 4,915 familje në vlerën 2,526,710 lekë, bazuar në neni 70, pika 3 <i>drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor</i> ligji nr.9920, datë 19.05.2008 për Procedurat tatimore të ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme: T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare; T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme); Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC

				konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar; Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe òSektori Juridikò, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
5	Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2021, të Bashkisë Pogradec ka rezultuar se, llogaria 468 òDebitorë të ndryshëmò paraqitet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në shumën 57,139,720 lekë më pak. Nga rakordimi i të dhënave mbi detyrimet debitore nga subjektet, ndaj Bashkisë Pogradec me Sektorin e Tatim Taksave, ka rezultuar se këto detyrime janë në shumën 59,397,820 lekë, ndërsasipas të dhënave analitike të llogarisë 468 òDebitorë të ndryshëmò rezultojnë se në fund të vitit 2021, debitorët nga tatim taksat lokale paraqiten në shumën 2,258,100 lekë, nga 59,397,820 lekë që janë të evidentuar nga Sektori i Tatim Taksave. Pra debitorët sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar rezultojnë të jenë regjistruar më pak për shumën 57,139,720 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me parimet e kontabilitetit dhe përcaktimet në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.	Pika III.2.3 Faqe 50-62	I lartë	Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për të kryer rakordim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me detyrimet debitore të lindura nga mos pagesat e taksave dhe tarifave vendore dhe të pakontabilizuara për shumën 57,139,720 lekë, si dhe të kryej kontabilizimin e tyre, pas rakordimit, me qëllim paraqitjen e drejtë të kësaj llogarie (468 òDebitorë të ndryshëmò) në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

### I.c. Opinioni i auditimit.

Në përfundim të auditimit financiar, të ushtruar në Bashkinë Pogradec, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2021, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 261/1, datë 09.03.2022, me ndryshime, Grupi i auditimit ka arritur në **konkluzionin se**, pasqyrat financiare të vitit 2021, paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkisë Pogradec më 31.12.2021, me përjashtim të disa rasteve të cilat sipas opinionit tonë janë materiale, por jo të përhapura. Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Pogradec, mbi i proceduravetëplanifikimit, realizimit dhe zbatimit të buxhetit është konstatuar se Bashkia Pogradec, nuk është treguar realiste në planifikimin e buxhetit, kryesisht nga të ardhurat e veta, gjë e cila ka sjellë pasoja në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara veçanërisht atyre për investime, të cilat paraqiten me një realizim në masën 54 %. Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ka rezultuar se përgjithësisht ka funksionuar, por ka nevojë për një identifikim më të mirë të risqeve, rishikim të tyre dhe përcaktimin e aktiviteteve të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre.



## Opinionit i auditimit

### **Për drejtimin e Bashkisë Pogradec**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pogradec, për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare, duke kryer paraprakisht vlerësimin mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

### **Opinion me rezervë (i modifikuar).**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e 6 Bazës për Opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2021, referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme me ndryshime, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

### **Baza për opinionin me rezervë, ISSAI/IFPP 2705:**

Ne e kryem auditimin mbështetur në standardet e auditimit.<sup>1</sup> Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Pogradec, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme,<sup>2</sup> për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë.

### **Përshkrimi i çështjeve (ISSAI/IFPP 2701):**

1- Nga auditimi ka rezultuar se, objektet inventar të pasurive të paluajtshme, përgjithësisht (a) nuk janë të regjistruar në regjistrat shtetërorë të pasurive të paluajtshme (ASHK), si dhe për rrjedhojë nuk janë pajisur me titull pronësie, ose (b) janë të regjistruar, por nuk janë të pajisur me certifikatë pronësie. Nga të dhënat analitike (trajtuar hollësisht në RPA) rezulton se nga 2,672 asete të inventarizuara nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, vetëm 109 prona janë të regjistruara, si dhe nga këto, vetëm 31 janë të pajisura me titull pronësie.

Kjo ka sjellë që kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar Kreu III të Regjistrit të aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre pika 35; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga

<sup>1</sup>ISSAI/IFPP 2700 Formimi i opinionit dhe raportimi i pasqyrave financiare; ISSAI/IFPP 2701 Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në Raportin e audituesit të pavarur; ISSAI/IFPP 2705<sup>2</sup> Ndryshimet në opinionin e auditimit në Raportin e audituesit të pavarur; ISSAI/IFPP 2706 Paragrafi i çështjeve të tjera në Raportin e audituesit të pavarur dhe (ISSAI/IFPP 2200<sup>3</sup>).

<sup>2</sup>ISSAI/IFPP 2230 Evidenca e auditimit dhe ISSAI/IFPP 2500 Dokumentimi i auditimit





riorganizimi administrativo- territorialë, Kreu VI ÷Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeë dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshmeë i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeë pika 2.1 ÷Parimet e kontabilitetit në sektorin publikë

**2-** Nga rakordimi i të dhënave mbi detyrimet debitorë nga subjektet, ndaj Bashkisë Pogradec me Sektorin e Tatim Taksave, ka rezultuar se këto detyrime janë në shumën 59,397,820 lekë. Sipas tipologjisë, rezultojnë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej 339 subjekte në vlerën 26,359,607 lekë dhe 6,040 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 30,511,503 lekë, debitorë nga toka bujqësore 4,915 familje në vlerën 2,526,710 lekë.

Sipas të dhënave analitike të llogarisë 468 ÷Debitorë të ndryshëmë të paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financiar, rezulton se në fund të vitit 2021, debitorët nga tatim taksat lokale paraqiten në shumën 2,258,100 lekë, nga 59,397,820 lekë që janë të evidentuar nga Sektori i Tatim Taksave. Pra debitorët sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar rezultojnë të jenë regjistruar më pak për shumën 57,139,720 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeë.

#### **Çështje të tjera, ISSAI/IFPP 2706:**

**1-** Nga auditimi është konstatuar se realizmi i investimeve të planifikuara për vitin **2021** është në shumën 183,758 mijë lekë, nga 338,900 mijë lekë të planifikuara, ose në masën **54%** kundrejt planit. Kjo situatë është rrjedhojë e planifikimit të procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime që bien ndesh me disiplinën buxhetore, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 60% për asnjërin nga vitet objekt auditimi. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), gjë e cila nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku në fund të vitit 2021 janë në shumën 316,431 mijë lekë. Këto veprime nuk janë kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 ÷Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitë me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 ÷Për Financat e Vetëqeverisjes Vendoreë; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 ÷Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitë me ndryshime, si dhe pika 1 e neni 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar.

**2-** Nga Bashkia Pogradec, në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është evidentuar se, nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e riskut për periudhën objekt auditimi; pavarësisht kryerjes së mbledhjeve të GMS për vitin 2021, nuk ka të evidentuara vendime në formë shkresore, që vijnë si rezultat i çështjeve më problematike që janë diskutuar në këto mbledhje; nuk është hartuar Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave, si dhe nuk është hartuar gjurma e auditit dhe harta e proceseve për disa prej aktiviteteve kryesore të veprimtarisë, verime të cilat janë në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 8, germa a; neni 27, pika 1; neni 9,



pika 2; neni 16, pika 2 dhe 3, si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pogradec**

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Pogradec, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e udhëzimeve mbi përgatitjen e pasqyrave financiare, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSHö, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 374/1, datë 08.04.2022, ndryshuar me shkresën nr. 374/2, datë 04.05.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.04.2022 deri në datë 20.05.2022 në subjektin Bashkia Pogradec për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2021 deri në31.12.2021, u krye auditimi ÷Mbi Auditimi Financiarö nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B.Z, Përgjegjës Grupi
2. A.H, Auditues
3. K.P, Audituese

**Titulli:** Auditim Financiar

**Marrësi:** Bashkia Pogradec





## II.1. Objektivat dhe qëllimi.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimit që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 deri në datë 31.12.2021, si dhe do të ketë si fushëveprimi zbatimin e rekomandimeve, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm, realizimin e të ardhurave dhe treguesve buxhetore.

## II.2. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 374/1 datë 08.04.2022, si më poshtë:

- Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar; ligjet vjetore ÷Për buxhetin e shtetit të vitit 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme të ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.
- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

## II.3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

## II.4. Përgjegjësitë e audituesve.

*(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)*

## II.5. Kriteret e vlerësimit.

- *Standardet e Auditimit:*
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.



- *Akte ligjore:*
- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Ligji nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendore;
- Ligji nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore;
- Ligji nr. 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, etj.
- *Akte nënligjore*
- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 òPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- VKM nr. 187 datë 08.03.2017 òPër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, etj.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.
- *Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:*
- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshmeëndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore;
- Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 òPër përgatitjen e buxhetit vendor, etj.
- Rregullore e Brendshme òMbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH<sup>-së</sup>, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>-së</sup> nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme òMbi Procedurat e auditimit në KLSH<sup>o</sup>, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>-së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Pogradec, etj.

**II.6. Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.** Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë òParimet INTOSAI-tò ku përfshihet: ISSAI-P-1 òDeklarata e Limësò , ISSAI-P-10 òDeklarata e Meksikosò; Nivelin e dytë òStandardet e INTOSAI-tò ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 òParimet bazë të auditimit financiarò, ISSAI 400-499 òParimet bazë të auditimit të përputhshmërisë.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

#### **ISSAI-140 "Sigurimin e cilësisë"**

Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;



- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;
- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për t'u siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

#### **ISSA 130 “Kodin Etik”**

Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.
- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.
- Ruajtjen e sekretit profesional.
- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.
- Sjelljen profesionale.

#### **ISSAI 2315 “Risku”**

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ( $RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$ ), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

#### **ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”**

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

#### **ISSAI 2500 “Dokumentimi”**

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme (ISSAI/IFPP- 2230), duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit
- Rëndësia e evidencës së auditimit
- Burimet e evidencës së auditimit
- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

### **II.7. Metodave të auditimit.**

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, konkretisht 5 komponentët përbërës si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi,



përgjithësisht kanë funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe janë konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye janë zbatuar teste standard.

**II.8. Dokumentimi i auditimit (ISSAI/IFPP-2500)**, është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiare dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.

### III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

#### III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Pogradec është Njësi e Vetëqeverisjes vendore, e cila ka në përbërje të saj 8 Njësi administrative: Pogradec, Udenisht, Buçimas, Trbinjë, Dardhas, Çërravë, Velçan dhe Proptisht.

Nr.	Njësia	Fshatrat
1	Pogradec	Qyteti Pogradec
2	Udenisht	Udenisht, Memlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin, Buqez
3	Buçimas	Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gëshhtënjës, Remenj, Vërdovë, Bahçallëk
4	Çërrave	Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë
5	Dardhas	Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Derdushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj
6	Trebinjë	Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë
7	Proptisht	Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërrë, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore
8	Velçan	Fshatrat: Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë



Bashkia Pogradec e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të, bazuar në ligjin 115/2014 për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

#### Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Pogradec fokusohen kryesisht në:

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.



### **Veprimtaria e Bashkisë Pogradec.**

- Veprimtaria e saj bazohet në ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; ligjin nr. 115/2014 òPër ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisëò, etj.
- Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 31 anëtarë;
- Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë;
- Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësisve Administrative.

## **III.2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:**

### **III.2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.**

#### **Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm**

Nga Grupi i auditimit u krye vlerësimi mbi funksionimin e 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm, nga ku rezultuan mangësitë e mëposhtme:

#### **Titulli i gjetjes 1: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së janë evidentuar mangësitë e përshkruara më poshtë:**

##### **Situata:**

1- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e riskut për periudhën objekt auditimi, e cila do shërbente si një qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e kreut të administratës dhe do ishte e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

2- Në Bashkinë Pogradec pavarësisht kryerjes së mbledhjeve të GMS për vitin 2021, nuk ka të evidentuara vendime në formë shkresore, që vijnë si rezultat i çështjeve më problematike që janë diskutuar në këto mbledhje.

3- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i cili paraqet të gjitha llojet e monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të MFK-së, duke ndihmuar në identifikimin dobësive dhe mangësive e rrjedhimisht dhe identifikimin e masave dhe aktiviteteve për t'ò korrigjuar ato. Këto faza janë pikënisja për planifikimin e aktiviteteve që synojnë ngritjen dhe zhvillimin e MFK-së.

4- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave, mungesa e të cilit pengon identifikimin e hapave që do të ndërmerren për të arritur objektivat e njësisë publike dhe për minimizimin e risqeve apo mangësive.

5- Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është hartuar gjurmae auditit për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA dhe gjurmae auditit për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë pa TVSH, për procese kryesore të veprimtarisë si vjelja e të ardhurave, ndjekja e



<b>Kriteri:</b>	debitorëve, etj. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 8, germa a; neni 27, pika 1; neni 9, pika 2; neni 16, pika 2 dhe 3, si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
<b>Ndikimi:</b>	Mos hartimi i strategjisë, mos marrja e vendimeve nga GMS për minimizim të risqeve, mos hartimi i planit për monitorim të sistemeve të kontrollit të brendshëm, mos hartimi i një plan veprimi për aritjen e objektivave dhe moshartimi i gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve për aktivitetet kryesore të veprimtrisë, sjell pasoja në aritjen e objektivave, në përmirësimin e procedurave, evidentimin e dobësive, si dhe marrjen e masave korrigjuese.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kuarndit ligjor dhe manualit për MFK.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E mesme</b>
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i Institucionit, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues, Nënpunësi Zbatues, si dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me qëllim funksionimin sa më të plotë të komponentëve të MFK-së, duhet: 1- të marrin masa që të rishikojë dhe rivlerësojë në mënyrë periodike Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, e cila ndihmon në specifikimin në mënyrë të detajuar të trajtimit të risqeve në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti. 2- të marrin masa që temat më problematike, të cilat lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, jo vetëm të diskutohen gjatë takimeve periodike të realizuara nga GMS ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik, por edhe të dokumentohen vendimet e marra për diskutimet përkatëse. 3- të marrin masa që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në mënyrë që të jetë i mundur identifikimi i dobësive dhe mangësive, duke ndërmarrë edhe masat e duhura për të korrigjuar ato në vazhdimësi. 4- të marrin masa që të hartojë çdo vit Planin e Veprimit për aritjen e objektivave, duke përcaktuar afatet dhe strukturat përgjegjëse me qëllim realizimin dhe përmbushjen e tyre në kohë. 5- të marrin masa që të hartojë gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës, në mënyrë që të garantohet ecuria e aktiviteteve të këtyre proceseve.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** z. I.Xh, Kryetar i Bashkisë Pogradec, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe Nënpunësit Autorizues; zj. I.K, Drejtor i Financës, në Cilësinë e Nënpunësit Zbatues, si dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik.

### **Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm**

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Pogradec, rezultoi se:

#### **1. Organizimi dhe Funksionimi**

Bashkia Pogradec ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm, e miratuar si pjesë e strukturës, organikës së Bashkisë Pogradec miratuar me Vendim Nr. 37, datë 25.02.2021, me ndryshime.





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC

Nr.	Nga 01.01.2021 deri 31.12.2021 më	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Pozicioni gjatë vitit 2021
1	Ë.A	Përgjegjëse	Ekonomiste	36	2			P/Spektori
2	K.V	Specialiste	Juriste	18	6	Po	Po	Audituese
3	E.B	Specialist	Ekonomist	11	2			Auditues

Përbërja e sektorit NjAB, për vitin objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

**Nga vlerësimi i veprimtarisë së AB, u konstatuan këto mangësi:**

**Titulli i gjetjes 2:** Në Njësinë e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Pogradec vihet re se, punonjësja që ka qenë Përgjegjëse në NjAB gjatë vitit 2021, nuk ka qenë e pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm.

**Situata:** Për vitin 2021 Përgjegjës i NjAB ka qenë zj. Ë.A, e cila duke nisur nga data 17.10.2019 ka qenë me emërim të përkohshëm deri në përfundim të procedurave të konkurrimit, referuar Urdhërit Nr.545, nr. 7247 prot., datë 17.10.2019, deri në datën 18.06.2020, që është emëruar me Vendim Nr. 144, datë 18.06.2020, nr. 2840 prot., si Përgjegjëse e NjAB. Ajo nuk ka pasur një certifikatë të audituesit të brendshëm, që nga momenti i emërimit të saj si përgjegjëse e NjAB e deri në momentin e daljes së saj në pension, duke përfunduar marrëdhëniet e punës me Vendim Nr. 310, nr. 5654 prot., datë 03.12.2021.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Neni 11, pika 2 b) dhe Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.

**Ndikimi:** Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm. Certifikimi i Përgjegjësit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm kontribuon, në përgatitjen e audituesit për organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin; që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm; dhe të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë së saj, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes.

**Shkaku:** Nuk është zbatuar kuadri ligjor për punonjësit që punësohen si Përgjegjës në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, ku kërkohet



plotësimi i kushteve të posaçme për të qenë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe përvoja e punës të jetë 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.

**Rëndësia:**

**E mesme**

**Rekomandimi:**

Titullari i Bashkisë Pogradec duhet të marrë masa që, në pozicionin e Përgjegjës të Njesisë së Auditit të Brendshëm, të punësohet gjithmonë një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture duke mundësuar funksionimin e saj në mënyrë efektive.

**Titulli i gjetjes 3:**

**Në Bashkinë Pogradec nuk është planifikuar një program trajnimi dhe nuk janë organizuar trajnime për audituesit që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2021.**

**Situata:**

Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Pogradec vihet re se nuk janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale.

**Kriteri:**

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 20, pika 3 dhe Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave òPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò.

**Ndikimi:**

Mos realizimi i trajnimeve për stafin që është pjesë e NjAB, pengon zhvillimin e aftësive dhe ngritjen e nivelit profesional të tyre. Audituesve të brendshëm u njihet si trajnim i vijueshëm profesional pjesëmarrja në trajnime për auditimin e brendshëm, të organizuara nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe publikime në fusha që lidhen me auditimin e brendshëm.

**Shkaku:**

Nuk është zbatuar kuadri ligjor përsa i takon trajnimeve për punonjësit e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, pasi nevoja për këto trajnime përshkruhet në mënyrë periodike dhe në planin strategjik dhe vjetor, që harton vetë Njësia e Auditit të Brendshëm.

**Rëndësia:**

**E mesme**

**Rekomandimi:**

NjAB në Bashkinë Pogradec duhet të marrë masa për realizimin e trajnimeve profesionale të rregullta për stafin që është pjesë e kësaj njësie, në mënyrë që të arrihet zhvillimi i aftësive profesionale të tyre në fushën e auditimit.

**Titulli i gjetjes 4:**

**Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pogradec nuk ka dërguar Kartën e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi.**

**Situata:**

Pavarësisht se Karta e Auditimit është përgatitur nga Drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Pogradec, me shkresën nr.979 prot., datë 24.02.2020, ajo nuk është dërguar për informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, siç parashikohet në kuadrin ligjor përkatës.

**Kriteri:**

Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në



- sektorin publikë, Neni 14, pika b) dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ÷Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikë.
- Ndikimi:** Duke qenë se Karta e Auditimit është një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i NjAB të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.
- Shkaku:** Nuk është zbatuar kuadri ligjor për të dërguar Kartën e Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
- Rëndësia:** **E ulët**
- Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa qëKarta e Auditimit si një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.
- Titulli i gjetjes 5:** **Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2021.**
- Situata:** Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2021. Ky fakt mbështetur edhe në argumentin e dhënë nga Përgjegjësi aktual i NjAB, se nuk ka pasur ndryshime nga programi i sigurimit të cilësisë së vitit 2020, referuar shkresës nr. 979/1 prot., datë 02.03.2020 dhe si rrjedhojë nuk është parë e arsyeshme të hartohet një program i ri për vitin 2021.
- Kriteri:** Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik pika 7.1.1 dhe Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publikë.
- Ndikimi:** Programi i sigurimit të cilësisë duhet të përfshijë si vlerësime të brendshme ashtu dhe të jashtme. Mungesa e përgatitjes së tij pengonpërmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duke filluar me vlerësimet e brendshme të cilësisë dhe me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë bazuar në standardet dhe kodin e etikës. Përgatitja e tij në mënyrë periodike është e rëndësishme, pasi në këtë mënyrë bëhet i mundur reduktimi i mangësive dhe përmirësimi i veprimtarisë së NjAB.
- Shkaku:** Nuk është zbatuar kuadri ligjor për të hartuar Programin e Sigurimit



të Cilësisë së NjAB duke u bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

**Rëndësia:**

**E mesme**

**Rekomandimi:**

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pogradec duhet të hartojë në mënyrë periodike Programin e Sigurimit të Cilësisë të NjAB, për aq kohë sa ai shërben si një mjet apo tregues përpërmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm të njësisë publike.

**Konkluzione:**

**1.** Bazuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, audituesit e NJAB duhet të jenë të pajisur me certifikatën e AB. Sa më sipar ka rezultuar se zj.Ë.A e cila për vitin 2021 ka mbajtur dhe pozicionin e Përgjegjësës së Sektorit nuk e ka poseduar këtë certifikatë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Gjithashtu, planifikimi i nevojave të stafit për trajnim duhet të jetë i përvitshëm. Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njësive të Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Pogradec vihet re se nuk janë ndjekur rregullisht trajnime të vijueshme profesionale nga dy prej punonjësve, siç paraqitet edhe në tabelën më lart. Veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Neni 20, pika 3.

**2. Karta e Auditimit** është përgatitur nga Drejtuesi i Njësive të Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Pogradec, me shkresën nr.979 prot., datë 24.02.2020. Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II i Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave. Në Bashkinë Pogradec nuk rezulton një shkresë përcjellëse, ku të pasqyrohet dërgesa e Kartës së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Veprim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 14, pika b.

**3. Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2021** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për vitet 2021 ó 2023, me shkresën nr. 4690/1 prot., datë 13.10.2020. Plani strategjik përgjithësisht është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3., por nuk ka të specifikuar në përmbajtje të tij kufizimet e auditimit.

Bazuar në pasqyrën nr.3, për vitin 2021 janë planifikuar 7 (shtatë) angazhime auditimi, ku 7 (shtatë) janë përputhshmërie.

Plani vjetor për vitin 2021 gjithashtu ekziston në formë shkresore, bashkangjitur me planin strategjik, shkresa nr. 4690/1 prot., datë 13.10.2020. Ai është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.

**4. Programi i Sigurimit të Cilësisë** së NjAB në Bashkinë Pogradec për vitin 2021, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Pogradec. Pas intervistës me Përgjegjësën aktuale të NjAB, zj. K.V, për vitin 2021 nuk është hartuar dhe miratuar një Program i Sigurimit të Cilësisë, duke argumentuar nga ana e saj se nuk ka pasur ndryshime nga programi i vitit të mëparshëm pra 2020, referuar shkresës nr. 979/1 prot., datë 02.03.2020 dhe si rrjedhojë nuk është parë e arsyeshme të hartohet një program i ri për vitin 2021. Gjithashtu në Bashkinë Pogradec nuk ka një shkresë përcjellëse të Programit të



Sigurimit të Cilësisë, për në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, që të tregojë se Bashkia Pogradec funksionon me të njëjtin program. Veprimi i cili është në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 7.1.1.

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë kodin e etikës dhe standardet. Nëpërmjet tij, vlerësohet efikasiteti, efektiviteti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikohen mundësitë për përmirësim.

**5. Regjistri i Riskut për vitin 2021**, është hartuar nga NjAB e Bashkisë Pogradec dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në legjislacionin përkatës dhe në funksion të objektivave institucional, por shkresa nuk ka numër protokollit dhe datë. Ky regjistër përfshin disa nga risqet e identifikuara si, identifikimi i riskut dhe sistemeve/fushave për tu audituar, risku i mosinformimit kryesor financiar, menaxherial dhe operacional i saktë, i besueshëm dhe në kohë; vlerësimi i riskut; vlerësimi i kontrollit të brendshëm; risku i rekomandimeve jo konkrete dhe të paklasifikuara sipas rëndësisë së riskut; dhënia e rekomandimeve në kohën e duhur; risku i moszbatimit në kohë të rekomandimit; risku i moszbatimit nga neglizhenca e subjektit të audituar por edhe nga mosmbështetja e titullarit të njësisë publike; risku i mosrealizimit të objektivave. Për të gjitha këto risqe të parashikuara janë përshkruar edhe kontrollet ekzistuese, vlerësimi i secilës prej pikave të riskut, nevoja për kontrolle të mëtejshme dhe zotëruesit e riskut.

**6. Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.**

Sipas Planit Strategjik të periudhës 2021- 2023, i nënshtrohen auditimit të plotë:

Për vitin 2021, i janë nënshtuar procesit të auditimit Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar (vlerësimi i procedurave të detyrimeve të prapambetura); Qendra Kulturore ëLasgush Poradeci; Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Asetet; Drejtoria e Kontrollit, Mbrojtja e Territorit (Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit); Drejtoria e Burimeve Njerëzore (Sektori i Burimeve Njerëzore); Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në dosjet e auditimit të vitit 2021, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon dhe në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm. Konkretisht:

Subjektet e audituara	Përmbajtja e dosjes
1. Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar	- inventarin e dosjes, - autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim,
2. Qendra Kulturore ëLasgush Poradeci	- deklaratat e konfliktit të interesit,
3. Drejtoria e Kontrollit, Mbrojtja e Territorit	- programi i angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, procesverbal takimi fillestar, projekt-axhenda,
4. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	- procesverbal takimi përmbyllës,
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	- plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve,
6. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	- informacion mbi zbatimin e rekomandimeve,
7. Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Asetet	- shkresë përcjellëse e projektit ó raportit, projekt ó raporti, - memo, - shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar dhe raporti përfundimtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura për vitin 2021, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 ëPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, bazuar edhe te Manuali i Auditimit të Brendshëm. Nga auditimi i projekt - raportit dhe raportit përfundimtar rezulton se në procesin e auditimit në përgjithësi, nga audituesit e brendshëm, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, ëEvidentimi dhe dokumentimi i punës audituese, në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e





subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimit që do të ndiqen dhe grupin e auditimit. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

**7. Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë për auditimet e vitit 2021**, sipas shkresës nr. 167/2, datë 08.02.2022, është përgatitur sipas formatit që specifikohet në Manualin e Auditimit të Brendshëm në pikën 7.1.1., ku monitorimi i vazhdueshëm në të gjithë hapat e angazhimit të auditimit duhet të fokusohet në një numër të caktuar pyetjesh për kriteret e vlerësimit të cilësisë. Për të gjitha auditimet e realizuara si Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar (vlerësimi i procedurave të detyrimeve të prapambetura); Qendra Kulturore "Lasgush Poradeci"; Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Asetet; Drejtoria e Kontrollit, Mbrojtja e Territorit (Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit); Drejtoria e Burimeve Njerëzore (Sektori i Burimeve Njerëzore); Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Sigurimi i Cilësisë gjatë vetëvlerësimit periodik dhe rishikimi i cilësisë, për angazhimet e auditimit të brendshëm për vitin 2021, përgjithësisht janë në dosjet e përhershme të auditimeve përkatëse.

#### **8. Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm, hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit**

Për veprimtarinë e NJAB për vitin 2021, është raportuar në mënyrë sistematike të Kryetari i Bashkisë Pogradec. Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar nga Përgjegjësi i NJAB në bazë të Planit Vjetor. Vend të veçantë në programin dhe në procesin e auditimit ka zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.

**9. Raporti i Veprimtarisë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021, me shkresën nr.167/1 prot., datë 08.02.2022, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 i ndryshuar.

**10. Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2021**, është hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1510, datë 29.03.2022.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 1 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1 datë 20.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1690/4, datë 20.05.2022 dhe Aktkonstatimi nr. 2 datë 20.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1690/5, datë 20.05.2022, si dhe është trajtuar hollësisht në PRA. Mbi trajtimin e kësaj çështjeje në PRA janë paraqitur observacione nga Zj. K.V me shkresën nr. 1690/12, datë 23.06.2022, të cilat janë sqaruar më poshtë.**

#### **Trajtimi i observacioneve:**

##### **1. Pretendimi i subjektit, Bashkia Pogradec:**

Për periudhën e auditimit, vitin 2021, unë K.V kam qënë specialiste e NJAB-së në Bashkinë Pogradec deri në dt.20.01.2022. Duke qënë specialiste unë kam qënë njëkohësisht dhe anëtare e grupit të auditimit për auditimet e realizuara gjatë vitit 2021. Pra unë kam realizuar detyrat që më jepte neni 16 i ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" si audit i brendshëm. Duke patur parasysh këtë unë nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi të cilat ligji ia ngarkon drejtuesit të njësisë të auditimit të brendshëm në nenin 14. Unë jam çertifikuar si audit i brendshëm dhe kam zhvilluar çdo vit trajnimin e vijueshëm profesional që në 30.09.2017, fakte të cilat ju i keni pasqyruar edhe në projektraport mbështetur dhe me





dokumentacionin përkatës të cilin ju kam vënë në dispozicion gjatë auditimit. Rekomandimi i lënë për këtë gjetje është i zbatuar paraprakisht me emërimin tim si përgjegjëse e çertifikuar dhe me përvojë pune 5 vjet si audit i brendshëm (Vendimi I kryetarit nr.24 dt.20.01.2022).

### **1.1. Përgjigje për pretendimin:**

Ashtu siç citohet edhe nga ju vetë, për periudhën objekt auditimi, pra viti 2021, ju zj. K.V keni qenë specialiste në NjAB në Bashkinë Pogradec, ndërkohë që gjetja bazohet në fenomenin që realisht ka ndodhur në Bashkinë Pogradec gjatë vitit 2021 dhe i referohet personit që ka qenë Përgjegjës në atë periudhë, pra zj. E.A dhe fenomenit që është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 11, pika 2 b).

Fenomeni është i tillë që, në NjAB në Bashkinë Pogradec për vitin 2021, zonja që ka qenë Përgjegjëse e NjAB, pra zj. E.A, nuk ka qenë e pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm. Në gjetjet që pasqyrojnë grupi i auditimit, evidentohen fenomene që nuk kanë qenë në zbatim të ligjit, për persona që kanë qenë në detyrë në periudhën për të cilën po kryhet auditimi dhe jo për periudhën kur po kryhet auditimi. Pasi periudha për të cilën është kryer auditimi, e theksoj se ka qenë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, ndërsa periudha kur grupi i auditimit ka ushtruar auditimin në Bashkinë tuaj ka qenë në vitin 2022. Edhe pse zj. E.A nuk është më Përgjegjëse e NjAB konkretisht, për periudhën që ne kemi patur si objekt auditimi ajo ka qenë Përgjegjëse, deri në momentin që ka dalë në pension dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës me Vendim Nr. 310, nr. 5654 prot., datë 03.12.2021.

Kështu që kjo gjetje nuk është e adresuar për ju si person, por për fenomenin që është konstatuar në Bashkinë Pogradec për vitin 2021, lidhur me funksionimin e NjAB. Madje edhe mënyra sesi është formuluar gjetja, ka qenë e tillë që të theksohet pjesa që në pozicionin e Përgjegjës të Njesisë së Auditit të Brendshëm, të punësohet gjithmonë një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture duke mundur funksionimin e saj në mënyrë efektive, pasi nga auditimi për vitin 2021, rezultoi e kundërta. Ju, zj. K.V, jeni emëruar Përgjegjëse e NjAB në Bashkinë Pogradec në periudhën 20.01.2022, me Vendim Nr. 24, nr. 47/3 prot., datë 20.01.2022 dhe referuar këtij fakti ekziston mundësia që ta paraqisni rekomandimin tonë si të zbatuar në auditimin e radhës, pasi nuk ka qenë në kompetencat tona të auditimit vitin 2022, i cili përkon me periudhën kur ju jeni emëruar Përgjegjëse e NjAB.

### **2. Pretendimi i subjektit, Bashkia Pogradec:**

Programet e trajnimit për audituesit dhe punonjësit aktualë të Njesisë të Auditimit të Brendshëm planifikohen dhe organizohen nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë (Neni 20 I ligjit 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò).

#### **2.1. Përgjigje për pretendimin:**

Në gjetje është cituar se në Bashkinë Pogradec nuk është planifikuar një program trajnimi dhe nuk janë organizuar trajnime për audituesit që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2021. Kjo do të thotë se, vetë Bashkia Pogradec nuk ka planifikuar trajnime për punonjësit që janë pjesë e NjAB. Trajnimet që zhvillon Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE dhe që ju i keni ndjekur janë marrë në konsideratë gjatë auditimit nga grupi i auditimit dhe dihet se ato trajnime nuk varen nga ju, se kur programohen për tu ndjekur. Prandaj dhe rekomandimi i adresohet Bashkisë Pogradec dhe është lënë me synimin që vetë Bashkia të planifikojë në vijim trajnime për punonjësit e NjAB.

### **3. Pretendimi i subjektit, Bashkia Pogradec:**

Kartën e auditimit të brendshëm e kemi dërguar dorazi në Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë. Gjithashtu në



vlerësimin e jashtëm të cilësisë të realizuar nga Drejtoria e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë në 27.05.2019 deri në 31.05.2019 kjo kartë është audituar dhe na është lënë detyrë përditësimi i saj. Në zbatim të këtij rekomandimi karta e auditimit është përditësuar në bazë të shembullit tip të marrë nga Drejtoria e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave gjatë trajnimëne të vijueshme profesionale.

### **3.1. Përgjigje për pretendimin:**

Karta e Auditimit të Brendshëm dërgohet me shkresë përcjellëse në MFE, pasi dërgesa dorazi nuk mund të vërtetohet nga grupi i auditimit. Aq më tepër që për çdo dokument, që specifikohet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik (konkretisht për Kartën e Auditimit të Brendshëm specifikohen detaje të Neni 14, pika b), dhe që duhet dërguar në MFE, në mënyrë që të vërtetohet respektimi i ligjit përsa i takon procesit të dërgesës, duhet të ketë shkresë përcjellëse, që vërteton pjesën se ju e keni adresuar dërgesën e këtij dokumenti në MFE. Prandaj është parë e arsyeshme, e nevojshme dhe e domosdoshme, që për këtë pjesë të lihet rekomandim.

### **4. Pretendimi i subjektit, Bashkia Pogradec:**

Standarti 1310-Kërkesat e Programit të Siguri dhënies dhe Përmirësimit të cilësisë përcakton që Programi i siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë duhet të përfshijë si vlerësime të brendshme ashtu edhe të jashtme. Pra ky standart nuk flet për përditësimin çdo vit të aktit të programit të sigurimit të cilësisë çdo vit por realizimin e tij nëpërmjet tre komponentëve. Nga njësia e auditimit të brendshme, në Bashkinë Pogradec në të gjitha auditimet e realizuara gjatë vitit 2021 janë realizuar të tre komponentët (monitorimi i vazhdueshëm; vetëvlerësimi periodik dhe studimi i një subjekti të audituar) fakt të cilin e keni konstatuar edhe ju në akt-verifikimin dhe projektin e auditimit në (paragrafin e fundit të faqes 17 dhe paragrafin e parë të faqes 18). Gjithashtu është realizuar komponenti i dytë me shkresë nr.167/2prot. Dt.08.02.2022 lista e kontrollit për të vlerësuar cilësinë e kriterëve gjatë vetëvlerësimit periodik të cilësisë të brendshme për vitin 2021 (po jua dërgojmë bashkëlidhur). Pra ky dokument ÷vetëvlerësimi periodik si komponenti i dytë i programit të sigurimit të cilësisë bëhet çdo vit. Në çdo dosje auditimi është realizuar monitorimi i vazhdueshëm dhe studimi i një subjekti të audituar. Gjithashtu në raportin e vitit 2021 dërguar (me shkresë 167/1 prot., Dt.08/02/2022) në Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë është raportuar edhe për realizimin e këtij programi të cilësisë të brendshme (raportin jua kemi vënë në dispozicion gjatë auditimit dhe ju e keni trajtuar vlerësimin e tij në faqen 18 të projektraportit).

Programin për sigurimin e cilësisë së Njësisë të Auditimit të Brendshëm e kemi dërguar dorazi në Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë. Gjithashtu në vlerësimin e jashtëm të cilësisë të realizuar nga Drejtoria e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë në 27.05.2019 deri në 31.05.2019 ky program është audituar dhe na është lënë detyrë përditësimi i saj. Në zbatim të këtij rekomandimi Programin për sigurimin e cilësisë është përditësuar në bazë të shembullit tip të marrë nga Drejtoria e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave gjatë trajnimëne të vijueshme profesionale.

### **4.1. Përgjigje për pretendimin:**

Rekomandimi që është lënë ka të theksuar se, në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, për vitin 2021. Madje në Akt Konstatimin që është lënë për NjAB në Bashkinë Pogradec, por shprehur gjithashtu edhe në projekt raport, është marrë në konsideratë që ju keni funksionuar gjatë vitit 2021 me programin e cilësisë të përgatitur që në vitin 2020, pasi e



keni gjykuar të arsyeshme që duke qenë se nuk ka pasur ndryshime, mos të hartonit një program të ri të sigurimit të cilësisë.

Mbështetur në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 7.1.1, citohet se *“Programi për Sigurimin e Cilësisë ..... kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit të auditimit të brendshëm.....”*. Referuar sa më sipër, në mënyrë që përmirësimi të jetë i vazhdueshëm, duhet që bazuar në manual edhe përgatitja e këtij programi të bëhet në mënyrë periodike, për të lejuar përmirësimin në vazhdimësi të gjithë veprimtarisë së NJAB në Bashkinë Pogradec.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** z. I.Xh, Kryetar i Bashkisë Pogradec, në cilësisë e Titullarit të Institucionit dhe zj. E.A, Përgjegjëse e NJAB në Bashkinë Pogradec, për periudhën objekt auditimi.

**II.2.2.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.**

**2.1-Programimi i PBA 2021-2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021**

-Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organimizin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.

-Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimeve publike, pastrimi, gjelbërimi, ndricimi, mirëmbajtja e segmenteve rrugore, programi i administrimit të pyjeve dhe bujqësisë, mirëmbajtja e kushteve për infrastrukturën arsimore, konvikteve, promovimi i politikave kulturore dhe sociale, zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe ekspozitave. Është bërë analiza për pagat dhe janë llogaritur pesha specifike e këtyrë llojeve të shpenzimit me totalin.

-Fushat me prioritet në shpenzimet për investime:

- a.Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit
- b.Ndërtimi i veprave publike (ujësjellës)
- c.Rikonstrukcion të objekteve shkollore.
- d.Mirëmbajtje të rrugëve dhe ndricimi i tyre.

Këto programe buxhetore afatmesme janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore”*.

Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, sektorët e Bashkisë, sektori i shërbimeve etj. gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

PBA dhe buxheti vjetor 2021 janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht:

PBA 2021-2023, bashkë me buxhetin vjetor 2021, janë miratuar me VKB nr.144, datë 24.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.prot, 2/1, datë 07.01.2021

në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti parardhës	67,527	



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti parardhës	89,878	
3	Trashëguar nga transferta specifike	27,123	
4	Të trashëguara nga FZHR	-	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	589,037	
6	Granti	431,564	
7	Transferta e kushtëzuar	941,632	
8	Transferta specifike	204,780	
9	Transferta specifike, rritje paga në arsim	11,206	
10	Ndryshim në buxhet	24,064	
11	Trashëgimi pa destinacion	390	
1	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		552,747
2	Shpenzime operative (602)		550,894
3	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		338,900
4	Shpenzime (603+604)		-
5	Transfertë e kushtëzuar (606)		994,242
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>2,387,201</b>	<b>2,387,201</b>

**2.2-Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Qeverisja Qendrore të granteve nëpërmjet transfertës të pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i celjeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë celur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në celjen fillestar të vitit. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

**Tabela e ndryshimeve të buxhetit të vitit 2021**

*Në 000/lekë*

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr.datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa.Art.	Shuma	Pakësim.Art.	Shuma	
Viti 2021	VKB nr.144 datë 24.12.2020	1,225,771	V.K.B.nr.15 date 05.02.2021	9,000	600+601	15.688			
					602+604+606	93.048			
					230+231	24.364			
			V.K.B. nr.30 date 19.02.2021	6,500	231	6,500		231	6,500
			V.K.B.nr.24 date 19.02.2021	11,206	600	11,206		604	11,206
			V.K.B. nr.30 date 19.03.2021	184,528	600	15,793			
					602	66,516			
					231	102,219			
			V.K.B. nr.43 date 06.05.2021	2,000	231	2,000		602	2,000
			V.K.B. nr.86 date 19.10.2021	4,800	231	4,800		231	4,800
V.K.B.nr.113 date 16.12.2021	24,064	602	24,604		604	24,604			
<b>Totali Viti 2021</b>	<b>1,225,771</b>	<b>219,798</b>							



-Në hartimi e projekt buxhetit vjetor, nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor parardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Pogradec dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër konstatojmë se janë kryer ndryshime të vazhdueshme, **ku në vitin 2021** kanë ndodhur **7** ndryshime me vlerë **219,798 mijë lekë**, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

#### **Titulli i gjetjes 6: “Ndryshimet buxhetore gjatë periudhave ushtrimore”.**

##### **Situata:**

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Pogradec dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit 2021 ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Pogradec.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Kështu **në vitin 2021** kanë ndodhur **7** ndryshime me vlerë **219,798 mijë lekë**, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së





produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

- Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* nën 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 *ËPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit* të ndryshuar, pikat 253 dhe 354.
- Impakti:** Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.
- Shkaku:** Mos planifikim i saktë i shpenzimeve buxhetore nga strukturat përgjegjëse.
- Rëndësia:** **E lartë**
- Rekomandimi:** Sektori i Financë/Buxhetit, në bashkëpunim me Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësit Autoriues dhe zj. I.K në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së buxhetit dhe Nëpunësit Zbatues.

### **2.3-Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Pogradec, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Pogradec, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferata e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti ushtrimor 2021 referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*në 000/lekë*

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
1	600 ó Paga	473,473	416,694	88
2	601 ó Sigurime shoqërore	79,274	69,177	87
3	602 ó Shpenzime operative	515,475	336,490	65
4	Totali shpenzime të tjera ó (606, 604, 609)	38,447	38,329	100
5	Investimet (230 + 231)	338,900	183,768	54
	<b>Totali</b>	<b>1,445,569</b>	<b>1,044,458</b>	<b>72</b>





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADec

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit rezultojnë nga 50 % deri në 80%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit nuk planifikohen mbi nevojat që Bashkia Pogradec ose realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike më të madhe në buxhet në raport me totalin e zënë shpenzimet për paga, ndjekur nga shpenzimet operative.

Nr.	Përshkrimi	Përqindja në raport me totalin
		Viti 2021
1	Shpenzimet operative	32
2	Investime	17
3	Shpenzime për pagat	40
4	Shpenzime për sigurime Shoqërore	6
5	Të tjera shpenzime	3

#### Titulli i gjetjes 7: “Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre”.

##### Situata:

Nga Grupi i KLSH konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin **2021** paraqitet në masën **54%**, nga vlera planifikuar prej **338,900 mijë lekë** është realizuar vlera prej **183,768 mijë lekë**.

Sipas Grupit të KLSH, kjo vjen nga planifikimi i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/ blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 60% për asnjërin nga vitet objekt auditimi. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku në fund të vitit **2021** janë në shumën **316,431 mijë lekë**.

##### Kriteri:

Në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 *“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”* me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 *“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”* me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

##### Impakti:

Si rezultat i planifikimit të procedurave pa siguruar burimin e tyre, i cili vjen ngatë ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhura kur ky plan nuk realizohet dhe mos parashikimi i faturave të palikujduara, çojnë në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

##### Shkaku:

Planifikimi i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport



me planin dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave realizimi i të ardhurave për asnjërën nga periudhat nuk paraqitet me realizim.

**Rëndësia:**

**E lartë**

**Rekomandimi:**

-Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Pogradec, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të viteve paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

-Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Pogradec.

-Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësit Autoriues dhe zj. I.K, në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së buxhetit dhe Nëpunësit Zbatues.

**Miratimi i buxhetit faktik**

Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Pogradec janë miratuar buxhetet faktik. Në relacionet përfundimtare të zbatimit të buxhetit janë hartuar vetëm realizimin e treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk shoqërohen me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmisimin e situatës.

**Fondi rezervë/dhe kontigjencës**

Për vitin 2021, është miratuar në vlerën 1,000 mijë lekë, vlerë e cila nuk është përdorur.

**Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Pogradec**

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Pogradec ka marrë donacione për periudhën objekt-auditimi perkatësisht **për vitin 2021** në vlerën 2,552,000 lekë. Kjo shumë përfaqëson fonde nga òUNDPö për 2 projekte të financuara.

Projekti i I-rë ka për qëllim mbulimin me fonde të shpenzimeve të ndryshme për paga dhe sigurime, makineri për atelienë në shumën 576,000 lekë.

Projekti i II-të, mbulon me fonde õshërbime të integruara për individët me problematika të lëvizshmërisë, ka për qëllim rikonstruksionin e qendrës për personat me aftësi ndryshe. Shpenzimet për këtë projekt janë 834,000 lekë për blerje pajisje dhe furnizime, në vlerën 112,000 lekë për fletëpalosje dhe në vlerën 611,493 lekë për mirëmbajtjen e ambienteve të fizioterapisë.

Ndërsa nga Bashkia Pogradec gjatë kësaj periudhe janë kryer subvencione, si vijon:

Për vitin 2021, është subvencionuar vlera prej 8,382,614 lekë, vlerë e cila i përket subvencionit për Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, në bazë të marrëveshjes nr.18, datë 31.01.2012 dhe Vendimit nr.3, datë 19.04.2016, ku Bashkia Pogradec ka detyrimin e pagesës prej 5% të vlerës së të ardhurave të realizuara nga Operatori i Ujësjetllës Pogradec për punën e kryer si agjent tatimor në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Si dhe vlera prej 27,773,628 lekë për transferime korrente tek Klubi i Futbollit Pogradec, kjo vlerë i është transferuar klubit të futbollit për paga, sigurime dhe shpenzime operative.



#### 2.4-Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuajuara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore.

Nga Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2021 ó 31/12/2021, paraqiten gjithsej 3 fatura me vlerë 84,317 mijë lekë, konkretisht pasqyra:

Nr.	Nr.datë fature	Shuma	Nr.USH	Vlera	Diferenca
1	Nr.1 date 18.02.2021	47,242,348	Nr.110 date 19.02.2021	20,000,000	20,242,348
			Nr.1147 date 28.12.2021	7,000,000	
2	Nr.16 date 28.05.2021	35,576,805	Nr.412 date 01.06.2021	33,191,783	2,385,022
3	Nr.29 date 16.10.2020	1,497,956	Likuiduar 2020	321,682	976,274
			Nr.394 dt 24.05.2021	200,000	
<b>Shuma</b>		<b>84,317,109</b>		<b>60,713,465</b>	<b>23,603,644</b>

**Titulli i gjetjes 8:** “KLSH-ja, konstaton se nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2021, ka konstatuar kryerjen e pagesave mbi afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës për likuidim, duke shtyrë radhën e likuidimeve dhe mos likuidimin e tyre në vlerë të plotë”.

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditor** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion.

Nga Bashkia Pogradec (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2020 ó 31/12/2021, paraqiten gjithsej **3** fatura me vlerë **84,317 mijë lekë**.

**Kriteri:** UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *õPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaõ*, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *õPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreõ* neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 *õPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëõ*, i ndryshuar, neni 52.

**Impakti:** Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

**Shkaku:** Likuidim me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh. Ndërsa një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likuidim nga MFE në fund të vitit ushtrimor 2021, duke shtyrë radhën e likuidimeve.

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Pogradec, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përyjashtuar kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësit Autoriues dhe zj. I.K në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së buxhetit dhe Nëpunësit Zbatues.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEÇ**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2021, nuk janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog.602	Llog.230+231	Vendime gjyqësore
Viti 2021	305,214,008	55,000,000	Nr.144 date 24.12.2020	25,000,000		30,000,000
<b>Totali</b>						

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2021, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e lartë.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës 0 Detyrimet e prapambetura, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

**Tabela nr.1 – Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2021**

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2020	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021-31.12.2021	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021
Investime	82,016,486	-	82,016,486	6,197,916	75,818,570
Investime nga FZSHH	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbime	103,718,466	7,260,222	110,978,688	261,600	110,717,088
Vendime gjyqësore	118,877,527	-	118,877,527	19,027,334	99,850,193
Të tjera	601,529	29,443,825	30,045,354	-	30,045,354
<b>Totali</b>	<b>305,214,008</b>	<b>36,704,047</b>	<b>341,918,055</b>	<b>25,486,850</b>	<b>316,431,205</b>

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:

Për periudhën 2021, detyrimet e raportuara janë vlerën 316,431,205 lekë, sipas ditarit të bankës dhe urdhër-shpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion.

**-Mbi vendimet gjyqësore**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021, nuk ka patur shtesa. Janë likujduar gjatë kësaj periudhe vlera prej 19,027 mijë lekë. Mbetet akoma pa likujduar shuma prej 99,850 mijë lekë ose rreth 31% e totalit të detyrimeve të raportuara.

Për rrjedhojë kemi një nivel shumë të lartë të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

**-Raportet e Monitorimit**

Për vitin 2021, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

**Për vitin 2021:**

- Janë dërguar raportet 4-mujore



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

- Raporti vjetor ó dërguar me shkresën nr. 214/1 datë 18.02.2022

**2.5-Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financë/ Buxhetit për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

Tabela mbi financimet e kontratave për investime, burimet e financimit si dhe likuidimet sipas viteve

000/lekë

Nr	Objekti i kontratës	Fond Planifikimi	Burimi i Financimit	Kontrata me subjektin			Subjekti i kontraktuar	Pagesa sipas periudhave				Mbetet pa likuiduar
				Nr.datë	Afati	Vlera me TVSH		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	
<b>I.Me fonde nga Ministritë e Linjës dhe donacione</b>												
1	Rikonstruksion Permiresimi i banesave Viti 2021 80 % Ministria 20 % Bashkia	14,267,951	Ministria e Brendshme	17/15.10.20	3 muaj	10,271,767	A-S shpk	9,987,566	283,896	-	-	305
2	Perfundimi i rrjetit te kanalizimeve Buçimas Periudha 2021-2024	26,792,502	Ministria e Buqesisë dhe zhvill.rrural	20/10.11.20	3 muaj	26,473,396	4 A	-	188,753	-	-	26,284
3	Ndertimi i ujesjellesit Rajonal Çerrave Dardhas burimet e Gurrasit periudha 2021-2024		MIE	350/3 dt 25.03.2021	18 muaj	929,823	C shpk	-	-	186,173	-	743,650
4	Ujesjellesi i Mokres Faza e II periudha 2021-2024		MIE	224/22 dt 13.04.2021	22 muaj	264,000	R shpk	-	-	52,999	-	211,001
<b>Totali I</b>						<b>1,230,568</b>		<b>9,988</b>	<b>284</b>	<b>239,361</b>	-	<b>955,711</b>
<b>II.Me fonde nga të ardhurat e vet</b>												
1	Rikonstruksion Permiresimi i banesave Viti 2021 80 % Ministria 20 % Bashkia		Të ardhurat e Bashkisë	3973/19 dt 09.11.2021		4,892	I	-	-	-	-	4,892
<b>Totali II</b>						<b>4,982</b>						<b>4,982</b>

- **Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donatorë të tjerë,** janë lidhur për vitin 2020 dhe 2021 gjithsej 4 kontrata në vlerën 1,230,569 mijë lekë. Për këto kontrata janë likuiduar në vitin 2020 në vlerën 9,988 mijë lekë, për vitin 2021 në vlerën 284 mijë lekë dhe në vitin 2022 në vlerën 239,361 mijë lekë. Rezulton se mbetet akoma për likuidim vlera 955,711 mijë lekë.
- **Për financimet nga buxheti Bashkisë Pogradec dhe Grande.** Janë lidhur për vitin 2021 gjithsej 1 kontratë në vlerën 4,982 mijë lekë, për të cilën nuk ka asnjë likuidim dhe vazhdon të mbetet e pa likuiduar në vlerën 4,982 mijë lekë.

**Titulli i gjetjes 9: “KLSH nga auditimi konstaton se kontratat e investimeve me fondet e FSHZH, fondet e buxhetit të Shtetit (Ministrisë së linjës), dhe të ardhurat e veta, nuk likuidoheshin sipas afateve të përcaktuara në kontratë”.**

**Situata:** Nga auditimi rezulton se kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Pogradec nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore. Nga verifikimi i të dhënave, konstatohet se fondet e akorduara nga Ministritë e Linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha.





Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Pogradec për vitin 2020-2021 dhe grandeve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirfilltë.

Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Pogradec (Sektori i buxhetit), **nuk merret në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 60%, nuk ka në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të larta.**

**Kriteri:** *Veprime këto në kundërshtim* me nenin 40 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80-81, të udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

**Impakti:** Mungesa e monitorimit të fondeve në fillim të procedurës, ndikon në mos marrjen e masave për përmirësimin e planifikimit përdorimin e fondeve me efektivitet, ndërsa mos evidentimi i saktë i detyrimeve dhe mos likuidim i tyre sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

**Shkaku:** Mos përcaktim të saktë të detyrimeve dhe mos planifikimi në radhë të parë i fondeve për shlyerjen e tyre, çon në rritjen e detyrimeve kreditore në fund të periudhave.

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

-Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

-Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Pogradec, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësit Autoriues dhe zj. I.K në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së buxhetit dhe Nëpunësit Zbatues.

#### **-Realizmi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre.**

Për periudhën objekti auditim 01/01/2020 ó 31/12/2021, nga auditim i evidencave të marra në Sektorin Financë/Buxhetit dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Pogradec, përdorimi i të ardhurave, u konstatua se:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC

Për vitin 2021, me të ardhurat e veta Bashkia Pogradec mbulon 3% të vlerës së investimeve, 30% të fondit të pagave, 0% të fondit të sigurimeve shoqërore, 23% të shpenzimeve operative, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën si vijon:

#### Të ardhurat e vitit 2021

Përshkrimi	Plan 2021	Fakt 2021
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2020	67,527	67,527
Të trashëguara nga transf.specifike 2020	27,123	27,123
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2020	89,878	89,878
Të ardhurat e veta të vitit 2021	589,037	355,755
Grante të pakushtëzuara viti 2021	431,564	463,907
Grante specifike të vitit 2021, të detajuara:	107,673	95,093
-Nga FZSHH		
-Nga Ministrinë e Linjës	569,060	
-Donatorë të ndryshëm		
-Transf.buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	994,242	994,242
-Nga huatë		
<b>Totali</b>	<b>1,205,237</b>	<b>1,004,285</b>

#### Përdorimi i të ardhurave viti 2021

Emërtimi	Fakt 2021				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr.Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte	11,724,520	8,328,000	2,396,520	1,000,000	20%
231-Investime	693,348,168	130,909,587	22,190,230	540,248,351	3%
600-Paga	185,596,266	117,544,995	56,820,712	11,230,559	30%
601-Sigurime shoqërore	30,364,582	29,067,776	-	1,296,806	-
602-Shpenzime operative	236,279,962	168,650,343	54,510,244	13,119,375	23%
604-Transf.Institucioneve	38,377,715	2,348,521	33,864,001	2,165,193	88%
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	991,844,363	6,494,184	229,579	985,120,600	0%
Kuotë qarku	1,000,000	-	1,000,000	-	100%
Të tjera ( Donatore)	3,320,555	564,031	2,756,524	-	83%
<b>Totali</b>	<b>2,191,856,131</b>	<b>463,907,437</b>	<b>173,767,810</b>	<b>1,554,180,884</b>	<b>7%</b>

### Struktura organizative e Bashkisë Pogradec

Miratimi i Strukturës për vitin 2021 është kryer me vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 37 ,datë 25.02.2021 me prot 983, bashkëngjitur vendimi nr.189, datë 01.09.2021 nr.983/2 dhe vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.51, datë 14.02.2020, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

#### Pasqyra e pagave për vitin 2021 Bashkia Pogradec

Emertimi	Plan	Fakt	%	
Kap.1 (Granti)	600	118,123	99%	
	601	31,802	29,067	91%
Kap.5(Te ardhurat)	600	72,285	56,821	78%
	601	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>222,210</b>	<b>203,432</b>	<b>91%</b>	

**Konkluzion:** Nga auditimi rezulton se numri i punonjësve në plan dhe në fakt nga viti 2020 në vitin 2021 ka ardhur në rritje përkatësisht në plan dhe në realizim. Kjo rritje e numrit të punonjësve është e pa argumentuar, ku të përcaktohen objektivat pse ka ardhur kjo shtesë.

Për rrjedhojë nga analizimi i përdorimit të fondeve referuar tabelave më sipër rezulton se **gati 30% e shumës së transfertës së pakushtëzuar** për vitin 2021 nga buxheti i shtetit shkon vetëm për fondin e pagave dhe sigurimeve.

Ky fenomen tregon se për investimet e Bashkisë Pogradec, duke qënë se transfertat e pakushtëzuar ezaurohet vetëm me fondin e pagave, Bashkia është e detyruar ti mbulojë investimet vetëm nga të ardhurat e veta të cilat janë në nivel të ulët realizmi. Për rrjedhojë



kjo fryrje e organikës e pa argumentuar con në një situatë të vështirë financiare Bashkinë.

### **Kontratat kryesore për investimet kapitale**

**Në analizë kontratat me burim financimi Ministrinë e Linjës:**

**-Projekti** “Ndërtim i ujësjellësit rajonal Çërravë & Dardhas – Burimet e Gurrasit”.

Ky investim është kontraktuar nga Bashkia Pogradec e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila ka rezultuar fitues OE öCö sh.p.k dhe është lidhur kontrata në datën 25.03.2021 në shumën 929,823 mijë lekë me tvsh.

**-Projekti** “Ujësjellës i Mokrës Faza e II-të”.

Ky investim është kontraktuar nga Bashkia Pogradec e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila ka rezultuar fitues OE öRø sh.p.k dhe është lidhur kontrata në datën 08.04.2021 në shumën 264,000 mijë lekë me tvsh.

**-Projekti** “Përfundimi i gjithë rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në njësinë administrative Pogradec dhe nëjsive administrative Buçimas, Bashkia Pogradec”.

Ky investim është kontraktuar nga Bashkia Pogradec e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila ka rezultuar fitues OE øA øø sh.p.k dhe është lidhur kontrata në datën 19.03.2021 në shumën 943,765 mijë lekë me tvsh.

Nga auditimi konstatohet se për këto investime të përshkruar më sipër **nuk kemi një plan të detajuar të këtyre fondeve** sipas përcaktimeve të cituara në Ligjin nr.57, datë 02.06.2016 òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, ku cdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.

**Titulli i gjetjes 10:** “Angazhimi pa fonde në dispozicion i ndërmarë nga Bashkia Pogradec për kontratat e lidhura për investime kryesisht me burim financimi të ardhurat e veta”.

**Situata:** Bashkia Pogradec për vitet buxhetore 2020 dhe 2021, ka planifikuar të ardhurat e veta **në vlera jo reale dhe të pa argumentuara**, ka një rritje artificiale të planit të të ardhurave fenomen që vihet re edhe nga realizimi i tyre **në nivele jo të mira**.

Nisur nga ky fenomen gjatë planifikimit të buxhetit vjetor 2021, Bashkia Pogradec ka planifikuar të kryejë shpenzime kapitale dhe korrente bazuar mbi transfertën e pakushtëzuar dhe planit të të ardhurave jo real. Për rrjedhojë konstatohet një përqindje shumë e ulët e realizimit të investimeve të planifikuar, pasi fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (transf.e pakushtëzuar), përdoret për mbulimin e **fondit të pagave dhe sigurimeve në masën rreth 30% duke qënë se në Bashkinë Pogradec rezulton një strukturë e organikës me numër të lartë punonjësish, tendencë kjo që ka ardhur në rritje nga viti në vit.**

**Kriteri:** *Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet nr.50, nr.51 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar pikat 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 65 79 -80-81-82, të udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

**Impakti:** Mungesa e planifikimit real të të ardhurave, numër i lartë punonjësish i pa argumentuar, kontratat për investime me burim financimi të ardhurat e Bashkisë të ndara në 3 vite.

**Shkaku:** Mos përcaktim të saktë të detyrimeve dhe mos planifikimi në radhë të parë i fondeve për shlyerjen e tyre, çon në rritjen e detyrimeve kreditore në fund të periudhave.

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Bashkisë Pogradec të merren masa për rishikimin e strukturës së punonjësve dhe rritjes së numrit të organikës e pa nevojshme, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Pogradec.

Drejtoria e Buxhetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi të ardhurat e bashkisë të mos kryejë copëzimin e fondeve për të shmangur detyrimet e prapambetura që cojnë në një situatë të vështirë financiare.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme si dhe të hartojnë një plan për respektimin e disiplinës buxhetore për investimet kapitale.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec dhe Nëpunësit Autoriues dhe zj. I.K në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së buxhetit dhe Nëpunësit Zbatues.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3 datë 20.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1690/6, datë 20.05.2022. Mbi këtë Aktkonstatimi nuk janë paraqitur observacione.**

**Drejtimi nr.2.6** ÷Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve

**Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec, kryhet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ku për vitin 2021 është miratuar struktura nga Kryetari i Bashkisë me 9 punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 8 (tetë) inspektorë, trajtuar në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr, datë	Urdhri largimit Nr, datë	Pozicioni i punës
a	b	1	3	4	5	6
1.	A.P	Përgjegjës	I lartë	Vendim nr.348 datë 26.12.2019		Përgjegjës
2.	E.T	Jurist	I lartë	Vendim nr.225 datë 14.09.2021		Jurist
3.	E.Sh	Specialist për llogaritjet/ rakordim për taksat dhe tarifave	I lartë	Vendim nr.468 datë 31.08.2016		Specialist
4.	E.P	Specialist për llogaritjet/ rakordim për taksat dhe tarifave	I lartë	Vendim nr.198 datë 16.12.2014		Specialist
5.	M.S	Specialist për llogaritjet/ rakordim për taksat dhe tarifave biz.	I lartë	Vendim nr. 84 datë 07.04.2021		Specialist
6.	A.M	Shefi i Njësisë	I lartë	Vendim nr.601 datë 13.09.2021		Shef
7.	E.D	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 183 datë 10.03.2020	nr.116/22	Punonjës
8.	A.K	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 553 datë 10.07.2020		Punonjës
9.	O.Z	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	mesëm	Urdhër nr. 404 datë 27.09.2019		Punonjës
10.	I.H	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 47 datë 23.01.2020		Punonjës



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

11.	M.P	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 826 datë 06.12.2019		Punonjës
12.	V.L	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 835 datë 16.12.2019		Punonjës
13.	E.B.	Punonjëse Administrative	I lartë	Urdhër nr. 548 datë 18.10.2019		Punonjës
14.	A.J	Punonjës për mbledhjen e tarifës të parkimit të automjeteve	_	Urdhër nr. 690 datë 30.09.2021		Punonjës
15.	R.J	Punonjës për mbledhjen e tarifës të parkimit të automjeteve	mesëm	Urdhër nr. 40 datë 05.03.2018		Punonjës
16.	F.Sh	Punonjës për mbledhjen e tarifës të parkimit të automjeteve	_	Urdhër nr. 594 datë 10.09.2021		Punonjës
17.	K.B	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 48 datë 23.01.2020		Punonjës
18.	E.C	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr.271 datë 14.04.2020		Punonjës
19.	T.E	Punonjës për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	I lartë	Urdhër nr. 35 datë 21.01.2020		Punonjës

- Për vitin 2021, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.124, datë 21.10.2020 òPër miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pogradec të vitit 2021ò.

**Të dhëna mbi numrin e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet ndaj të cilëve janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:**

**Gjendja e bizneseve për vitin 2021**

Nr	Lloji i Biznesit	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i vogël	2020	1,519	269	155	1,545
		2021	1,545	183	118	1,610
2	Biznesi i Madh	2020	364	4	5	363
		2021	363	5	10	358
3	Gjithsej	2020	1,883	273	160	1,908
		2021	1,910	188	128	1,950

Nga të dhënat e tabelës konstatohet se:

**Për vitin 2020**, kanë ushtruar aktivitet 1,883 subjekte (1,519 subjekte të biznesit të vogël, 364 subjekte të biznesit të madh) kanë kryer regjistrim si aktivitete të reja 273 biznese, dhe kanë bërë çregjistrim 160 subjekte.

**Për vitin 2021**, kanë ushtruar aktivitet 1,910 subjekte (1,545 subjekte të biznesit të vogël, 363 subjekte të biznesit të madh) kanë kryer regjistrim si aktivitete të reja 188 biznese, dhe kanë bërë çregjistrim 128 subjekte.

Përsa më sipër konstatohet se:

- Kjo situatë sipas Bashkisë Pogradec tregon nivelin e ulët ekonomik të kësaj Bashkie, por sipas mendimit të Grupit të KLSH-së është edhe puna e pamjafuteshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave.

- Numri i bizneseve të mëdhenj ka ardhur duke u zbritur nga viti 2020 në vitin 2021, me 5 subjekte.

- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrjnë aktivitet tregëtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompiuterik të licensuar dhe të mbrojtur, veprim që bie në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar*”.

- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

**Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021**  
**Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2021.**

(në mijë lekë)

Nr	Lloji I Taksës	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
a	b	c	d	e
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>	-	-	-
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	-	-	-
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>	<b>197,835</b>	<b>90,476</b>	<b>46</b>
1	Taksa vendore B. Vogël	4,000	3,135	78
2	Taksa mbi ndërtesën	69,000	57,303	83
3	Taksa mbi tokën bujqësore	5,200	3,252	63
4	Taksë mbi truallin	4,400	3,740	85
5	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	30	-
6	Taksa vendore mbi shërbimin hotelier	9,525	6,301	66
7	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë	100,000	10,329	10
8	Taksa e tabelës	5,710	6,386	112
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga taksat e ndara</b>	<b>36,400</b>	<b>43,124</b>	<b>118</b>
1	Taksa mbi kalimin e pronësisë	6,200	3,673	59
2	Taksa mbi qarkullimin e mjeteve	20,000	22,098	110
3	Taksë e rentës minerare 5%	200	441	221
4	Taksa mbi të ardhurat personale 2%	10,000	16,912	169
5	Taksa të tjera	-	-	-
<b>IV</b>	<b>Te ardhura nga tarifat</b>	<b>297,604</b>	<b>207,500</b>	<b>74</b>
1	Tarifë për menaxhimin e mbetjeve	123,100	87,806	71
2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	100	-	-
3	Tarifë për ndriçimin publik	29,060	20,622	71
4	Tarifa për gjelbërimin	75,000	52,258	70
5	Tarifë për mirëmbajtjen e varrezave	13,000	8,350	64
6	Tarifa për shërbimet administr. të bashkisë	1,000	432	43
7	Tarifë për dhënien e licensave	-	-	-
8	Tarifë të kontrollit të zhvillimit të territorit	17,000	13,918	82
9	Tarifa për vulosje veterinare	770	695	90
10	Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit	1,000	759	76
11	Tarifa e parkimit	4,000	5,343	134
12	Tarifa për dhënie licensave dhe autorizime për tregëtimin e naftës	-	-	-
13	Tarifë për pyjet dhe kullotat	500	578	116
14	Tarifë për shërbimet shtesë nga zjarrfiksjat	200	194	97
15	Tarifë për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike	14,000	14,039	100
16	Tarifë për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-
17	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore	1,600	920	58
18	Tarifa nga dokumentet për prokurime, ankand etj.	-	-	-
19	Tarifa të tjera	-	3,201	-
20	Të tjera (ndikimi në mjedis)	1,000	831	83
21	Qendra kulturore e fëmijëve	380	114	30
22	Pallati i sportit	350	-	-
23	Cerdhet dhe Kopshtet	5,544	2,576	46
24	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-
25	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	500	-	-
26	Tarifa të tjera	4,600	3,220	70
<b>IV</b>	<b>Te ardhura e tjera</b>	<b>75,198</b>	<b>14,650</b>	<b>19</b>
1	Qera nga asetet në pronësi të Bashkisë	13,542	11,811	87
2	Kundravajtjet administrative (gjobat)	3,000	862	29
3	Grante nga ndihma ndërkombëtare	58,656	1,977	3
<b>GJITHSEJ (I+II+III+IV)</b>		<b>589,037</b>	<b>355,755</b>	<b>60</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i të Ardhurave, Punoi: KLSH

Bashkia Pogradec sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2021. Në mënyrë të përmbledhur planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi	Plan 2021	Fakt 2021	Realiz. %
1	Të ardhura nga taksat	197,835	90,476	46
2	Të ardhura nga taksat e ndara	36,400	43,124	118
3	Të ardhura nga tarifat vendore	279,604	207,500	74
4	Të ardhura e tjera	75,198	14,650	19
5	<b>Shuma</b>	<b>589,037</b>	<b>355,755</b>	<b>60</b>



Nga analiza e të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se:

Për vitin **2021** të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **589,037 mijë** lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën **355,755 mijë** lekë, ose **60%**, me një diferencë në vlerën **233,282 mijë** lekë të pa realizuara. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 107,359 mijë lekë, ose 54% të planifikimit, të ardhurat nga tarifave nuk janë realizuar në vlerën 72,104 mijë lekë, ose 26% të planifikimit, të ardhura nga debitorët nuk janë planifikuar dhe realizuar.

**Situatë e cila tregon një nivel të ulët dhe punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2021 të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjëndjen e faturave të palikujdurara dhe borxhin.**

Përsa më sipër konstatohet se:

-Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2021 planifikimi është për vlerën 100,000 mijë lekë. Nga të dhënat konstatohet se planifikimi është artificial pasi në Bashkinë Pogradec nuk ka një plan të përgjithshëm vendor të miratuar, për rrjedhojë nuk ka ndërtime të reja për të cilat të kemi realizim të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Realizimi për këtë takës në masën 10% për vitin 2021 ka ardhur vetëm nga mbledhja e taksës së legalizimeve nga ASHK Pogradec.

- Niveli i arkëtimin të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifave vendore paraqitet në vlera realizimi 70%.

-Për vitin 2021 vlerën më të lartë të mos realizimit të të ardhurave vendore e zenë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën 107,359 mijë lekë.

### **Planifikimi i gabuar dhe jo i saktë për taksën e tokës bujqësore për vitin 2021**

-Taksa mbi tokën bujqësore, për vitin 2021 nuk është realizuar, ku për vitin 2021 realizimi paraqitet në masën 63% ose nga 5,200 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 3,252 mijë lekë.

Nga të dhënat e nxjerra nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pogradec në lidhje me sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit, paraqitet si vijon:

Nr	Bashkia Pogradec dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej	Nga e cila				Familjet që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtores	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha
1	Pogradec	-	-	-	-			
2	Buçimas	1,382	1,169	213				
3	Udënisht	400	378	22				
4	Çërravë	1,752	1,421	331				
5	Proptisht	1,459	319	1,140				
6	Trebinjë	1,552	1,552	-				
7	Velcan	694	683	11				
8	Dardhas	776	693	83				
<b>Totali</b>		<b>8,015</b>	<b>6,215</b>	<b>1,800</b>				

Burimi: Të dhënat janë nxjerrë nga zyra e Tatim Taksave

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë së saj, dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu nëse vërejmë pasqyrat e mëposhtme do të konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj cfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme përsa i përket taksës së tokës bujqësore. Kjo tregon se Sektori i Taksave dhe Tarifave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADec

konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë, dhe për të realizuar një procesë sa më real të planifikimit të të ardhurave, veprim ose mosveprim që bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr. nr.9632, datë 30.10.2006 ðPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, ku thuhet se; “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka”.

Nr	Bashkia Pogradec dhe NJA	Sip e tokes gjithsej ha	Numri i familjeve gjithsej	Marre toke nga AMTP sip.ha	Marre toke e AMTP familje gjithsej
1	Pogradec	-	13,637	-	-
2	Buçimas	2,470	6,154	1,382	2,697
3	Udënisht	995	2,651	400	1,187
4	Çërravë	3,458	3,189	1,752	1,716
5	Proptisht	2,705	2,014	1,246	1,801
6	Trebinjë	3,527	1,059	1,552	1,547
7	Velcan	1,525	1,048	694	1,111
8	Dardhas	2,380	1,214	776	935
<b>Bashkia Pogradec Totali</b>		<b>17,060</b>	<b>30,966</b>	<b>7,802</b>	<b>10,994</b>

Nga tabela sa më sipër vihet re se në Bashkinë Pogradec janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **10,994** familje dhe që duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrit ligjor.

Në bashkinë Pogradec rezulton se toka bujqësore u përket kategorive II deri VII, sipas përkatësisë. Mungojnë regjistra dhe database ku të specifikohen saktë ndarja e fondit të tokës sipas kategorive, por nga analizat e hershme rezultojnë të jenë kategoria II nga vlerësimi i kryer nga Instituti Bujqësor.

#### Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit 2021
1	Kategoria I	2,800 lekë			
2	Kategoria II	2,100 lekë			
3	Kategoria III	1,400 lekë			
4	Kategoria IV	1,350 lekë	1,382	1,864,700	
5	Kategoria V	1,150 lekë			
6	Kategoria VI	1,100 lekë			
7	Kategoria VII-X	1,000 lekë	6,420	6,420,000	
8	<b>Totali</b>	-	<b>7,802 hektar</b>	<b>8,284,700</b>	<b>5,200,000</b>

-Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **3,084,700** lekë për vitin 2021 (8,284,700 ó 5,200,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për vitin 2021 në vlerën **3,084,700** lekë.

#### Titulli i gjetjes 11: Mbi planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore.

##### Situata:

Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Pogradec, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.



Këto veprime kanë çuar në mos planifikim të taksës së tokës për diferencën prej **3,084,700 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

**Kriteri:**

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendore, neni 23 ku cilësohet:“Taksa mbi tokën bujqësore 1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nën kategorizime. 2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji. 3. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. 4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë ose komunës, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme”.

**Impakti:**

Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore

**Shkaku:**

Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe koordinim i gabuar midisi sektorëve në marrjen e informacionit

**Rëndësia:**

**E lartë**

**Rekomandimi:**

Bashkia Pogradec duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **3,084,700 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

**Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** zj. A.P në funksionin e Përgjegjës të Sektorit të të ardhurave.

Në lidhje me Akt Konstatimin nr.4, është paraqitur observacion nga Bashkia Pogradec me shkresën nr.1690/3 prot, datë 23.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.974/7 prot, datë 27.06.2022.

**Pretendimi i subjektit:**

Shpjegim për gjetjen nr.6 ÷Mbi planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka në dispozicion listat e marra nga Drejtoria e Mbrojtjes së Tokës, por po has vështirësi të ndryshme në dokumentacion. Shumë persona nuk kanë certifikatë pronësie ose personi që është pajisur me dokument pronësie nuk jeton më dhe nuk është kryer çelja e trashëgimisë, për të ngarkuar me detyrime personat pronarë të saj. Për personat të cilët janë me dokumenta të rregullta po vazhdon kontrolli mbi saktësinë e të dhënave.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit**

Për sa i përket komentit tuaj mbi përditësimin e listave për personat që posedojnë tokë bujqësore duhet të kryhet një verifikim i saktë dhe i rregullt në mënyrë që planifikimi i të ardhurave nga toka bujqësore të jetë në vlera reale si dhe realizimi i tyre në nivele të larta. Për rrjedhojë komenti juaj nuk merret në konsideratë pasi nuk përbën argument.



**Mos aplikimi i saktë i tarifave vendore mbi subjektet që kanë në përdorim sipërfaqe të fondit pyjor kullosor të Bashkisë Pogradec**

Nga ana e Bashkisë Pogradec, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në: VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò, i ndryshuar. përsa i përket arkëtimit të të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore dhe Inproduktive që ndodhen në territorin e Bashkisë Pogradec. Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò, i ndryshuar, në të përcaktohet që:

*“Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysHEME, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”*

*LIDHJA NR.2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.*

*Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrrierë)*

*Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit***

*I vit 2-5 vjet 6-10 vjet*

*I Inproduktive 540 000 / 495 000 / **440 000**”*

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë, për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje, bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i të Ardhurave, Bashkia Pogradec, konstatohet se:

Në territorin e Bashkisë Pogradec ushtrojnë aktivitet privat 22 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, subjekte të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE dhe statusi i tyre për vitin 2021 që nuk janë lidhur kontrata qiraje.

U auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, dhe Inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Pogradec, nuk është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullosore për të cilat të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë me subjektet e trajtuara në vijim.

**Pasqyra e detyrimeve të subjekteve, periudha 01.01.2021-31.12.2021**

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=ha	Tarifa lek/ha	Detyrimi për vitin 2021
1	609	16.03.2001	B - 94 shpk	J73804663H	Hija e zeze	Krom	0.1	440,000 lek/ha	Pa kontratë
2	655	09.04.2002	K..B shpk	K24207608A	Miniera e kromit Pojske	Krom	6.74	440,000 lek/ha	Pa kontratë
3	721/1	05.09.2013	SH shpk	K14009617C	Saselisht	Gur gëlqeror	4.8	440,000 lek/ha	Pa kontratë
4	768/1	17.06.2015	N shpk	K33708682E	Çerrave	Gur gëlqeror	2.2	440,000 lek/ha	Pa kontratë
5	831	18.12.2004	B - 94 shpk	J73804663H	"Mademi", Peshkepi,	Kuarc	1	440,000 lek/ha	Pa kontratë
6	910	01.09.2005	F 1 shpk A. shpk	K33708651V	Guri Kuq	Hekur Nikel	2.3	440,000 lek/ha	Pa kontratë
7	939/1	18.04.2006	B - 94 shpk	J73804663H	Perroi I Gllaves, Çerrave	Gur gëlqeror	0.5	440,000 lek/ha	Pa kontratë
8	981	12.12.2006	D.O shpk	K74310602V	Damba Hudenisht	Hekur Nikel	9.9	440,000 lek/ha	Pa kontratë
9	1022	13.06.2007	R.M	L64202602B	Çervenake (Fe_Ni, Ni_Si)	Hekur Nikel	7.9	440,000 lek/ha	Pa kontratë
10	1114	12.12.2007	J -06 shpk	K64006602O	Çervenaka Juglindore	Hekur Nikel	65	440,000 lek/ha	Pa kontratë
11	1242	24.09.2008	R shpk	J93711608Q	Çervenaka Jug Lindore	Hekur Nikel	55	440,000 lek/ha	Pa kontratë
12	1357	04.06.2009	J2008 shpk	K83804603N	Çervenaka Lindore	Hekur Nikel	1.75	440,000 lek/ha	Pa kontratë
13	1530	24.12.2010	O M shpk	K91902009P	Memlisht - 4, Udenisht	Hekur Nikel	893.4	440,000 lek/ha	Pa kontratë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Nr	Leje	Data e lejes	Emërtimi i Subjektit	Nipt	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=ha	Tarifa lek/ha	Detyrimi për vitin 2021
14	1665	04.09.2013	D.S shpk	L21707008U	Rodokal	Krom	16	440,000 lek/ha	Pa kontratë
15	1729	08.10.2014	N.C	L04806601C	Objekti Leshnicë	Krom	93	440,000 lek/ha	Pa kontratë
16	1781	12.11.2015	B -94 shpk	J73804663H	Objekti Trebinjë	Rërë kuarc	8.8	440,000 lek/ha	Pa kontratë
17	1838	24.07.2017	A.S	L51608023A	Obj. Bllace, Çerrave.	Gur gëlqeror	6.6	440,000 lek/ha	Pa kontratë
18	1854	16.02.2018	B 94 shpk	J73804663H	Proptisht	Kuarc	2.2	440,000 lek/ha	Pa kontratë
19	1882	18.12.2019		L81606012A	Miniera qymyrit Çerrave	Hekur Nikel	48	440,000 lek/ha	Pa kontratë
20	1892	01.07.2020	A	L74701401P		Qymyr Guri	29.1	440,000 lek/ha	Pa kontratë

**Titulli i gjetjes 12: Mos aplikimi i saktë i tarifave vendore mbi subjektet që kanë në përdorim sipërfaqe të fondit pyjor kullësor të Bashkisë Pogradec.**

**Situata:** -Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Pogradec, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore dhe Inproduktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Pogradec, nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (kARRIERË) me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor toke Inproduktive.

**Kriteri:** - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ðPër sistemin e taksave vendore, neni 35 ku cilësohet: "1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur: a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj. 2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent.

-VKM nr. 391, datë 21.06.2006 ðPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, i ndryshuar, pika nr.2, e lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mos aplikimi i tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e shërbimit pyjor në Bashkinë Pogradec, të marrin masa të ngrihet grup pune për të kryer verifikimin në terren të subjekteve të cilat janë pajisur me leje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Pogradec.

Për këto subjekte të evidentuara zona e lejuar e shfrytëzimit të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor dhe të kalojë si pasuri minerare në varësi



të Ministrisë së Linjës.

Deri në momentin e heqjes nga fondi pyjor i Bashkisë Pogradec, të merren masa për të lidhur kontratat me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec, zj. A.P në funksionin e Përgjegjësit të Sektorit të të ardhurave dhe z. A.B në funksionin e Përgjegjësit të Sektorit të shërbimit pyjor.

Në lidhje me Akt Konstatimin nr.4, është paraqitur observacion nga Bashkia Pogradec me shkresën nr.1690/3 prot, datë 23.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.974/7 prot, datë 27.06.2022, si dhe observacion me shkresën nr.1690/4 prot, datë 01.07.2022, protokolluar në KLSH me nr.374/8 prot, datë 04.07.2022

#### **Pretendimi i subjektit:**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të gjitha subjektet të cilat shfrytëzojnë aktivitete bazuar në lejen e dhënë nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë i ka ngarkuar detyrimet për taksa dhe tarifa vendore, kurse lidhja e kontratës është detyrim i Sektorit të Shërbimit Pyjor në Bashkinë Pogradec. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dërgon vetëm njoftim vlerësimin për kontratat e qirasë të lidhura nga Sektori i Shërbimit Pyjor.

Në juridiksion të territorit të Bashkisë Pogradec, aktualisht ushtrojnë veprimtarinë minerale/shfrytëzim karriere në fond pyjor 6 subjekte dhe jo 22 subjekte. Për dy subjekte janë marrë vendimet përkatës për heqjen nga fondi pyjor. Për katër subjekte të tjera i është kërkuar me anë të shkresave zyrtare detyrimi ligjor, që duhet të fillojnë procedurën për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që posedojnë sipas lejeve përkatëse.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Për sa i përket komentit tuaj mbi subjektet të cilat shfrytëzojnë aktivitete të bazuar në lejen e dhënë nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë detyrimin për të lidhur kontratat me to është specifikuar që i takon Sektorit të Shërbimit Pyjor e detajuar në rekomandimin përkatës.

Në lidhje me pretendimin për subjektet të cilat ushtrojnë veprimtarinë minerale/shfrytëzim, lista analitike e tyre është informacion i marrë nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e përditësuar në faqen zyrtare, si dhe për subjektet të cilat janë të evidentuara janë dhënë rekomandimet përkatëse për heqjen nga fondi pyjor dhe deri në momentin e heqjes nga fondi pyjor i Bashkisë Pogradec të lidhen kontratat përkatëse nga Sektori i Shërbimit Pyjor. Për rrjedhojë pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

#### **Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.**

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Pogradec, **për disa subjekte është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet**, janë hartuar akt marrëveshje për pagesën e detyrimit me këste por nuk gjen zbatim në përcaktimet ligjore të bëra në *nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për*





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

*tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar VKM 344, datë 19.04.2017, duke mos u arkëtuar të ardhurat për taksën e pajisjes së Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.*

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Pogradec për vitin 2021, paraqiten 14 subjekte.

Nga ana e Zyrës së Tatim Taksave nuk është zbatuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim, për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	NIPT	Data e fillimit të Autorizimit	Data e mbarimit të Autorizimit	Shuma për t'u paguar	Pagesa e kryer me këste deri 31.12.2021	Të ardhura të munguara
1	"H" SHPK	J64103645H			1,000,000	200,000	800,000
2	"A-D" SHPK	L32204031E			1,000,000	200,000	800,000
3	"S-G" SHPK	K04004205V			1,000,000	200,000	800,000
4	"E" SHPK	K04403606O			1,000,000	200,000	800,000
5	"A.P" SHPK	K04005016G			1,000,000	1,000,000	-
6	"B" SHPK	J73804662Ë			1,000,000	200,000	800,000
7	"B" SHPK	J73804662Ë			1,000,000	200,000	800,000
8	"B" SHPK	J73804662Ë			1,000,000	200,000	800,000
9	"G 2004"	K44802603B			1,000,000	1,000,000	-
10	"G 2004"	K44802603B			1,000,000	200,000	800,000
11	"O" SHPK	J63423463I			1,000,000	200,000	800,000
12	"G.C GKG"	K66801001T			1,000,000	200,000	800,000
13	"G.C GKG"	K66801001T			1,000,000	200,000	800,000
14	"G.C GKG"	K66801001T			1,000,000	200,000	800,000
<b>Shuma totale</b>							<b>9,600,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec, Punoi: KLSH

**Titulli i gjetjes 13: Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.**

**Situata:** -Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Pogradec, nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 9,600,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Pogradec.

**Kriteri:** - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, neni 35 ku cilësohet: “1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur: a) përkon me





*përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji. 2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifrat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifrat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent.*

- VKM nr.170, datë 25.4.2002 ÷Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4.

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ÷Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës ÷bë.

-**VKM nr. 344, datë 19.04.2017**, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.

**Impakti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pogradec, pasi kjo vlerë nuk është arkëtuar prej OE të cilësuar më poshtë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Bashkia Pogradec të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **9,600,000 lekë**, për subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:

-Subjekti **H sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **A.D sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **S sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **E sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **B sh.p.k.**, për vlerën prej **2,400,000 lekë**.

-Subjekti **G 2004 sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **O sh.p.k.**, për vlerën prej **800,000 lekë**.

-Subjekti **G.C sh.p.k.**, për vlerën prej **2,400,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec, zj. A.P në funksionin e Përgjegjësit të Sektorit të të ardhurave.

Në lidhje me Akt Konstatimin nr.4, është paraqitur observacion nga Bashkia Pogradec me shkresën nr.1690/3 prot, datë 23.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.974/7 prot, datë 27.06.2022.

**Pretendimi i subjektit:**

Shpjegim për gjetjen nr.8 ÷Mbi planifikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbureo, Drejtoria e Taksave ka zbatuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.123, datë 21.10.2020 për lehtësimin në pagesën e autorizimit të karburanteve në kuadër të



situatës së krijuar nga përhapja e Covid-19. Bazuar në Akt Konstatimin nr.4, pika 6 të lënë nga Auditimi i KLSH-së nr.1690/7, datë 20.05.2022 nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar shkresat subjekteve ku janë njoftuar për tu pajisur me autorizimin 5-vjeçar.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Për sa i përket komentit tuaj është pranuar rekomandimi i lënë nga Grupi i Auditimit të KLSH-së dhe po vihet në zbatim nga Bashkia Pogradec.

#### **Titulli i gjetjes 14: Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në datë 31.12.2021.**

##### **Situata:**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Pogradec në vlerën gjithsej **59,397,820** lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej **339** subjekte në vlerën **26,359,607** lekë, e pa kontabilizuar, dhe **6,040** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **30,511,503**lekë, debitorë nga toka bujqësore **4,915** familje në vlerën **2,526,710** lekë. Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së debitorëve që disponon Sektori i Tatim Taksave vendore me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, konstatohet se gjendja e debitorëve sipas kontabilitetitka mos përputhje. **Pra debitorët sipas Bilancit janë më pak se të dhënat e Zyrës së Tatim Taksave në fund të vitit 2021 për shumën 59,397,820 lekë.**

##### **Kriteri:**

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Kreu XI- *“Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104,Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesëtë transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguardhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995,òKodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. *“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”**

##### **Impakti:**

Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë



**Shkaku:**

**Rëndësia:**

**Rekomandimi:**

Pogradec dhe mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare  
Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët

**E lartë**

Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 339 subjekte në vlerën 26,359,607 lekë, e pa kontabilizuar, 6,040 familje për taksë toke, taksë ndërtesë, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 30,511,504 lekë, debitorë nga toka bujqësore 4,915 familje në vlerën 2,526,710 lekë, bazuar në neni 70, pika 3 *“E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”* ligji nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat tatimore të ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:*

*a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare, sipas neni 90, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.*

*b-Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), neni 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane të Shqipërisë të ndryshuar.*

*c-Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Spektori Taksa e Tarifa, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d-Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite Spektori Taksa e Tarifa dhe Spektori Juridik të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH i miratuar me ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 i ndryshuar, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z.I.Xh, në funksionin e Titullarit të Bashkisë Pogradec, zj.A.P në funksionin e Përgjegjësit të Spektorit të të ardhurave.

Në lidhje me Akt Konstatimin nr.4, është paraqitur observacion nga Bashkia Pogradec me shkresën nr.1690/3 prot, datë 23.06.2022, protokolluar në KLSH me nr.974/7 prot, datë 27.06.2022.

**Pretendimi i subjektit:**

Shpjegim për gjetjen nr.9 “Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në datën 31.12.2021”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka marrë masa për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor duke dërguar Urdhër për bllokimin e llogarive bankare, Urdhër për vendosjen e barrës hipotekore ndaj pasurive të paluajtshme, Urdhër për vendosjen e masës siguroese ndaj parusive të paluajtshme.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Për sa i përket komentit tuaj është pranuar rekomandimi i lënë nga Grupi i Auditimit të KLSH-së dhe po vihet në zbatim nga Bashkia Pogradec.



**Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontratat e qirave për objekte, troje toka bujqësore të pandara dhe kontrata për shfrytëzim të fondit pyjor, në Bashkinë Pogradec.**

Nga auditimi u verifikuan dokumentacioni si më poshtë:

Kontratat për objekte të marra me qira dhe likujdimi i detyrimeve për periudhën 2021,

Kontrata për troje të marra me qira dhe likujdimi i detyrimeve për periudhën 2021,

Kontrata për toka bujqësore të pandara, të marra me qira dhe likujdimi i detyrimeve për periudhën 2021,

Kontrata për fond pyjor, të marra me qira dhe likujdimi i detyrimeve për periudhën 2021,

*Auditimi mbi të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve dhe troje, për periudhën 2021, dhe likujdimi i detyrimeve të kontratave.*

Nga Sektori i Menaxhimit të Kontratave në Bashkinë Pogradec, për periudhën objekt auditimi administrohen **41 kontrata** qiraje për objekte dhe troje, vlera e këtyre kontratave është llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisështetërore.

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e objekteve dhe trojeve, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se 11 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën **22,798,289 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec, sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr	Objekti i dhënë me qëra	Subjekti	Detyrimi vjetor i qërasë	Pa u likujduar deri 31.12.21
1	Insta.antene Dogana Tushemisht 10.5 m <sup>2</sup>	P SHPK ó Z.M	17,220	103,320
2	Instalim antene Çërravë 500 m <sup>2</sup>	V-A - problem pronësie	550,000	11,000,000
3	HEC - Slabinja - 1 Proptisht	P-E ó N.K	1,157,415	553,167
4	HEC LLËNGË Velçan - Kanal derivac.7.59 km, Tubacion 2.21 km	H.LL SHPK ó H.Gj	2,877,476	272,310
5	Toke buqësore - sip.627.26 ha	"M.H& S"	2,142,400	8,569,600
6	Toke buqësore per mbjellje arror sip.1.615 Ha	B-94	11,305	11,305
7	Toke buqësore per mbjellje arror sip.16.4940 Ha	G.S	51,181	51,181
8	Magazinë mate. ndert. Lin 4995 m <sup>2</sup>	P.A ó R.B	219,718	439,436
9	Salla e Nder.EL-PO Metal shpk per montim sobash 150 m <sup>2</sup>	B-A SHPK ó M.C	270,000	270,000
10	Leje shfryte. krom - Tollovice Rodokal i Siperim 10,000 m <sup>2</sup>	M - F.V	78,000	30,000
11	Minere Fe-Ni ne Debrove	J-06 SHPK ó A.G	644,800	1,497,970
<b>Totali</b>				<b>22,798,289</b>

Sa më sipër nga Sektori i mbikëqyrjes së kontratave, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës me subjektet të cilët kanë marrë me qira objekte dhe hapsira publike, veprim në papajtueshmëri me germën “g”, neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura për objekte dhe troje të marra me qira.

**Titulli i gjetjes 15: Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontratat e qirave për objekte, troje toka bujqësore të pandara dhe kontrata për shfrytëzim të fondit pyjor, në Bashkinë Pogradec.**

**Situata:** -Nga sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën objekt auditimi administrohen **41 kontrata** qiraje për objekte dhe troje. Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e objekteve dhe trojeve, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se për **11 subjekte** nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën **22,798,289 lekë** që janë të ardhura të munguara për



	<p>buxhetin e Bashkisë Pogradec. Nga sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës me subjektet të cilët kanë marrë me qira objekte dhe hapsira publike, veprim në papajtueshmëri me germën “g”, neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndryshuar dhe kushtet e kontratave të lidhura për objekte dhe troje të marra me qira.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 12, gërma ògò. VKM nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.</p>
<b>Impakti:</b>	<p>Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mos shlyerja e detyrimeve kontraktuale.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i kuadrit ligjor</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p><b>E lartë</b></p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga Sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave, të marren masa për të arkëtuar shumën <b>22,798,289 lekë</b> për <b>11</b> subjekte debitorë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec. Për këto subjekte debitorë nga detyrimet kontraktuale të merren masa nga sektori i evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri të zgjidhja e kontratës.</p>

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** z. N.T, në funksionin e Përgjegjësit të Sektori të evidentimit të aseteve dhe monitorimit të kontratave.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4 datë 20.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1690/7, datë 20.05.2022. Mbi këtë Aktkonstatim nuk janë paraqitur observacionet në fazën e hartimit të Projektraportit të Auditimit, prandaj po shqyrtohen në fazën e hartimit të Raportit përfundimtar të auditimit. Observacionet e paraqitura janë shqyrtuar pas çdo çështjeje të observuar.**

**II.2.3. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.**

**Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:**

- Pasqyrat financiare të vitit 2021;
- Ditari i Bankës;
- Aktrakordimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet me Degën e Thesarit Pogradec;
- Inventarët etj.





**Nga auditimi ka rezultuar se:**

Bashkia Pogradec ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2021, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" me ndryshime. Kontabiliteti është mbajtur sipas programit òAlfa buxhetò, si dhe veprimet mbi kryerjen e transaksioneve gjatë viti (të ardhura dhe shpenzime) kanë kaluar nëpërmjet SIFQ.

**Pjesë përbërëse të PF/2021 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

*Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, me ndryshime ku është dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njesisë ekonomike raportuese, Bashkia Pogradec me NIPT K4480260R;
  - Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2021-31.12.2021;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
  - Data e depozitimit të Pasqyrave Financiare nga Bashkia Pogradec është 31.03.2022, miratuar nga Dega e Thesarit Pogradec më datë 11.05.2022.
  - Përgatitur nga I.K, Drejtore e Financës;
  - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Pogradec me shkresën nr. 1478, datë 28.03.2021, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec z. I.Xh.
- Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Pogradec, të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Pogradec dhe Specialisti i shpenzimeve, Specialisti i të ardhurave dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Pogradec, si më poshtë:
  - Aktrakordimi nr. 94, datë 01.02.2022 òPër të ardhuratò;
  - Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimetò;
  - Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga të ardhuratò;
  - Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga transfertat e pakushtëzuaraò;
  - Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga transfertat e kushtëzuaraò;
  - Aktrakordimi nr. 32, datë 11.01.2022 òPër mjetet në ruajtje, llogaria 466ò.

**Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" me ndryshime.





- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshime.

## **Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:**

### **1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=1,330,133,148 lekë.**

- Aktivet 1,858,780,614 lekë
- Pasivet 528,647,466 lekë
- Aktivet neto **1,330,133,148 lekë**

#### **Aktivet afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **380,463,450 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 ÷ Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre në shumën 186,289,114 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 ÷ Gjendje inventari qarkullues në shumën 9,976,834 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 ÷ Llogari të arkëtueshme në shumën 184,197,502 lekë.

#### **Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” përbëhet nga:**

- Vlera e llogarisë 520 ÷ Disponibilitete në thesarë në shumën 186,289,114 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogarisë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 130,308,187 lekë; gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 55,495,191 lekë, Mjete në ruajtje (pulla) në vlerën 485,736 lekë.
- Vlera e llogarisë 532 "Vlera të tjera", përfaqëson vlerën e blloqeve të parkimit, vlerën e biletave të tregut si dhe vlerën e pullave të postës të cilat për vitin 2021, kanë kaluar në Dr.e Taksave.

#### **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

- Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Pogradec në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 9,976,834 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 ÷ Materiale në vlerën 1,579,421 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 ÷ Objekte inventari në vlerën 8,397,413 lekë.
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 617,042 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 ÷ Ndryshimi gjendjes së inventarit në shumën - 617,042 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 1,579,421 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2020	1,217,878
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2021	9,589,407
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	9,227,864
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>1,579,421</b>

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 8,397,413 dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor. Lëvizjet e llogarisë 32 ÷ Objekte inventari paraqiten në tabelën e mëposhtme:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	8,141,914
Hyrje gjatë vitit 2021	1,718,041
Dalje gjatë vitit 2021	1,462,542
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>8,397,413</b>

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

#### Mbi kryerjen e inventarëve:

Janë kryer inventarët në mbyllje të vitit ushtrimor 2021, ku nga ana e Titullarit të Bashkisë Pogradec, kanë dalë urdhrat përkatës për ngritjen e komisioneve. Konkretisht:

- Urdhëri nr. 537, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në Bashkiò;
- Urdhëri nr. 538, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Buçimasò;
- Urdhëri nr. 539, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Çërravëò;
- Urdhëri nr. 540, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Udenishtò;
- Urdhëri nr. 541, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Dardhasò;
- Urdhëri nr. 542, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Proptishtò;
- Urdhëri nr. 543, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Trebinjëò;
- Urdhëri nr. 544, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në NJA Velçanò;
- Urdhëri nr. 545, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në Bashki dhe NJAò;
- Urdhëri nr. 546, datë 01.09.2021 òPër krijimin e komisionit të asgjësimit të aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata në Bashki dhe NJAò;

Nga Komisionet përkatëse janë hartuar Procesverbalet, mbi inventarizimin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre, sipas llogarive përkatëse. Procesverbalet e mbajtura janë firmosur nga anëtarët e komisionit. Janë mbajtur Fletët e inventarit të cilat janë firmosuar nga grupi i inventarizimi dhe personi përgjegjës.

Nga ana Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli IV, pika 120, inventarët mbi nxjerrjen jashtë përdorimi ju janë përcjellë të gjitha njësiteve përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se janë pasqyruar në mënyrë të saktë gjendja e inventarit në 31.12.2021, duke ju referuar rezultateve të inventarizimit. Gjendja në 31.12.2021, e këtyre llogarive sipas inventarit fizik i cili rakordon me atë kontabël dhe gjendjen në fund të këtyre llogarive të paraqitura në pasqyrën e mëposhtme:

Llogaritë	Përshkrimi	Gjendja fizike (inventarët)	Gjendja kontabël Pasqyra pozicionit financiar	Sipas Formatit 74/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata/kostohistorike"
202	Studime dhe kerkime	20,855,141	20,855,141	20,855,141
210	Toka, Troje, Terene	10,004,720	10,004,720	10,004,720
211	Pyje, Plantacione	23,737,562	23,737,562	23,737,562
212	Ndertesa e Konstruksione	184,033,923	184,033,923	184,033,923



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,590,832,784	1,590,832,784	<b>1,590,832,784</b>
214	Instalime teknike, makineri e paisje	22,334,181	22,334,181	<b>22,334,181</b>
215	Mjete Transporti	23,911,160	23,911,160	<b>23,911,160</b>
218	Inventar ekonomik	27,682,006	27,682,006	<b>27,682,006</b>
312	Materiale	1,579,421	1,579,421	
327	Inventar i imet	8,397,412	8,397,412	

**Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 126,387,809 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.220	116,512,222
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	27,258,537
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	17,382,950
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>126,387,809</b>

Debitorë	Gjendja 01.01.2020	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2021
Bashkia (nga ish komunat)	27,394,901			27,394,901
Debitorë IMT	10,188,206	8,799,537	550,000	18,437,743
Debitorë letra me vlere	3,525,700	18,459,000	16,832,950	5,151,750
Debitorë nga KLSH	55,796,717			55,796,717
Kontrata qeraje nga KLSH	17,348,598			17,348,598
Debitorë tatim taksa lokale	2,258,100			2,258,100
<b>Totali</b>	<b>116,512,222</b>	<b>27,258,537</b>	<b>17,382,950</b>	<b>126,387,809</b>

Peshën e detyrimeve e zenë; debitorët e krijuar nga rekomandimet e lëna nga KLSH me 57,8 % të debitorëve dheme nivel të lartë paraqiten detyrimet e krijuara nga IMT-janë në 18,437,743 lekë, ose në masën 44% te debitorëve.

**Titulli i gjetjes 16: Mbi kontabilizimin e detyrimeve debitorë (tatim taksa lokale).**

**Situata:**

Nga rakordimi i të dhënave mbi detyrimet debitorë nga subjektet, ndaj Bashkisë Pogradec me Sektorin e Tatim Taksave, ka rezultuar se këto detyrime janë në shumën **59,397,820 lekë**. Sipas tipologjisë, rezultojnë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej 339 subjekte në vlerën 26,359,607 lekë dhe 6,040 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 30,511,503lekë, debitorë nga toka bujqësore 4,915 familje në vlerën 2,526,710 lekë.

Sipas të dhënave analitike të llogarisë 468 Debitorë të ndryshëm të paraqitur më lart rezulton se në fund të vitit 2021, debitorët nga tatim taksat lokale paraqiten në shumën 2,258,100 lekë, nga 59,397,820 lekë që janë të evidentuar nga Sektori i Tatim Taksave. **Pra debitorët sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar rezultojnë të jenë regjistruar më pak për shumën 57,139,720 lekë.**

**Kriteri:**

Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

**Impakti:**

Impakton paraqitjen në mënyrë të drejtë të pozicionit të kësaj llogarie në kontabilitet (Pasqyra e pozicionit financiar)

**Shkaku:**

Mos veprim nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

**Rëndësia:**

**E lartë**



**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për të kryer rakordim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me detyrimet debitore të lindura nga mospagesat e taksave dhe tarifave vendore dhe të pakontabilizuara për shumën 57,139,720 lekë, si dhe të kryej kontabilizimin e tyre, pas rakordimit, me qëllim paraqitjen e drejtë të kësaj llogarie (468 ÷Debitore të ndryshëm) në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

**Për verimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** zj. I.K, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës.

Llogaria 4342 “Te tjera operatione me shtetin të drejta (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 57,809,693 lekë, Llogaria 7206 ÷Financim i pritshëm nga buxheti të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 19,106,189 lekë, ndërsa vlera e llogarive të klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, llogaritë 42, 431, 435 dhe 436 është në shumën 19,833,837 dhe përfaqësojnë detyrime të shtetit kundrejt bashkisë, me një diferencë prej 727,648 lekë (19,838,837-19,106,189), kurse vlera prej(38,703,504-727,648)lekë përfaqëson detyrime të prapambetura në Bashki të trashëguara nga bashkimi me ish-komunat, pa dokumentacion të rregullt, si dhe të paregjistruara nga thesari. Në mënyrë analitike paraqitet:

Nr.	Emërtimi i llogarive	Vlera
I	Llogaria 401	37,975,856
II	Financim i pritshëm nga buxheti 7260	19,833,837
II.1	Detyrime llogarite, 42, 431, 435 dhe 436	19,106,189
II.2	Detyrime pa fatura, të trashëguara	727,648
I+II	<b>Totali</b>	<b>57,809,693</b>

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, nga shuma 305,214,008 lekë në fillim të periudhës ushtrimore. Mbyllja e kësaj llogarie është bërë bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, pika 15.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	305,214,008
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	305,214,008
Gjendja në 31.12.2021	0

### **AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”,** përbëhen nga llog.202 ÷Studime dhe kërkime, në vlerën 20,855,141 lekë. Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është 5,836,055 lekë.

Diferenca 1,029,892 lekë (6,865,947-1,029,892) është vlera e amortizimit të AAJM, sipas pasqyrës anekse Formatit 7/b. Nuk ka patur shtesa gjatë vitit 2021.

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 1,449,997,583 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore, në shumën 505,961,411 lekë, transferimi kapital rruge pa pagese, investime Pogradeç, në vlerën



**KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEÇ**

109,943,945 lekë, Banesa sociale në shumën 30,710,765 lekë,prita lumenjsh 2,280,150 lekë etj.

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2020	Shtesa 2021	Pakësime 2021	Gjendje në fund
	AAGJM	930,090,340	695,843,012	189,881,601	1,449,997,583
210	Toka ,troje, Terrene	5,163,520	4,841,200	0	10,004,720
211	Pyje, Kullota Plantacione	23,737,562	0	0	23,737,562
212	Ndërtesa e Konstruksione	65,013,022	4,015,522	3,669,876	65,358,668
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	816,774,559	673,790,974	181,426,238	1,309,139,295
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	9,451,134	0	750,967	8,700,167
215	Mjete transporti	452,543	8,756812		9,209,355
216	Rezerva shtetërore				
217	Kafshe pune e prodhimi				
218	Inventar ekonomik	9,498,000	4,438504	1,745,102	9,901,984
24	Aktive afatgjata te demtuara	9,498,000	0	0	4,631,125
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	4,631,125	0	0	9,314,707
219	Amortizimi i AAGJM (-)	(416,049,867)	(45,453,805)		(461,503,672)

**Titulli i gjetjes 17: Aktivet Afatgjata Materiale mbi saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e vlerave të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2021.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se, objektet inventar të pasurive të paluajtshme, përgjithësisht nuk janë të regjistruar në regjistrat shtetërorë të pasurive të paluajtshme (ASHK), si dhe për rrjedhojë nuk janë pajisur me titull pronësie, si dhe janë të regjistruar, por nuk janë të pajisur me vertifikatë pronësie. **Konkretisht të dhënat paraqiten në tabelën e mëposhtme, sipas të cilës nga 2,672 asete të listuara, vetëm 109 prona janë të regjistruara, si dhe nga këto vetëm 31 janë të pajisura me titull pronësie.**

Kjo ka sjellë që kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyreò pika 35, ku cilësohet:“*Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: a. Dokumenta autorizues b. Dokumenta vërtetues c. Dokumente të kontabilitetit.*

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò, Kreu VI òTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò.

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshmeò i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 2.1 òParimet e kontabilitetit në sektorin publikò

**Impakti:** Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë njohjen e pronës dhe statusin juridik të saj, lë hapësirë për



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

interpretim jo të saktë të vlerës së pasqyruar në bilanc, si dhe minimizon potencialisht përdorimin e këtyre asetëve.

**Shkaku:**

Mungesë llikuiditetesh, fondesh për marrjen e këtij shërbimi nga ASHK.

**Rëndësia:**

**E lartë**

**Rekomandimi:**

Titullari i Bashkisë Pogradec, duhet të marrë masa për analizimin e situatës, përlllogaritjen e kostos për realizimin e këtij shërbimi, planifikimin në buxhet, si dhe nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së, të pasurive të paluajtshme, në emër të të Bashkisë Pogradec.

Tabela anekse nr. 17.1 òTë dhëna mbi astetò

Nr.	Emërtimi	Sasia	Me sipërfaqe totale	Me vlerë fillestare	Prona të regjistruara	Prona me certifikatë pronësie
1	Prona (shkolla etj)	104	104	80	10	10
2	Strehim dhe mbrojtje	71	71	47	0	0
3	Infrastrukturë	789	782	11	65	9
4	Kulturë dhe sport	64	64	0	4	0
5	Bujqësi ushqim	264	264	0	29	11
6	Shëndeti publik	48	48	22	0	0
7	Ujësjiellës kanalizime	121	121	24	0	0
8	Administrative	5	5	1	1	1
9	Pyje kullota	0	0	0	0	0
10	Ujitje dhe kullim	279	279	0	0	0
11	Varreza publike	138	138	0	0	0
12	<b>Totali</b>	<b>2,672</b>	<b>2,658</b>	<b>185</b>	<b>109</b>	<b>31</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec, Punoi: KLSH

*Llogaria 215 “Mjete transporti”.* Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Pogradec më datë 31.12.2021 në shumën 9,209,355 lekë. Krahasuar me vitin e më parshëm është shtuar në vlerën 8,756,812 lekë.

*Llogaria kontabël 218 “Iventar ekonomik”.* Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njesitë administrative, institucionet e Bashkisë Pogradec. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Pogradec gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 9,901,984 lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 218 òIventari ekonomikò është shtuar në vlerën 403,984 lekë.

*Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM& AAJM:Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Pogradec në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën (461,503,672) lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 219 òAmortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuarò paraqitet me shtesë prej 45,453,805lekë.*

- Teprica neto në fillim të vitit ushtrimor (kosto historike) paraqitet në vlerën 1,366,951,986 lekë, amortizimi i akumuluar në shumën 416,049,867 lekë dhe teprica neto në fillim të vitit në shumën 950,902,119 lekë (1,366,951,986-416,049,867).
- Amortizimi i akumuluar në fillim të vitit paraqitet në shumën 416,049,867 lekë, shtesat gjatë vitit në shumën 45,453,805 lekë, si dhe në fund të vitit në shumën 461,503,672 lekë (416,049,867+45,453,805).
- Teprica neto në fund të vitit 2021, në shumën 1,455,833,638 lekë,është e barabartë me 950,902,119 (teprica neto)-416,049,867 (shtesa e amortizimit)+695,843,012 (shtesa kosto historike)+45,453,805 (pakësim amortizimi)=1,455,833,638 lekë.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njesitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 36.





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materialesipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 14,139,629 lekë dhe 8,043,897 lekë, të cilat përfaqësojnë shpenzime kapitale në proces.

### **PASIVET (DETYRIMET)**

#### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pogradec më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	316,362,452	28,088,168	288,274,284
42	Detyrime ndaj personelit	13,679,220	13,770,277	-91,057
16,17,18	Hua Afat shkurtra			0
460	Huadhenes			0
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,843,612	1,048,014	795,598
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal			0
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore			0
435	Sigurime Shoqerore	3,794,002	3,770,138	23,864
436	Sigurime Shendetsores	517,003	517,012	-9
437,438,	Organizma te tjere shteterore			0
44	Institucione te tjera publike			0
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike			0
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere			0
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	55,980,927	34,172,488	21,808,439
467	Kreditore te ndryshem	9,724,727	302,387,489	-292,662,762
4341	Operacione me shtetin( detyrime	121,236,059	112,986,522	8,249,537

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2021 është në vlerën 316,362,452 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Pogradec më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 ÷Furnitorë e llogari të lidhura me to, paraqitet në tabelën si me poshtë, Diferenca 316,362,452- (28,978,777+288,111,123)=727,648 lekë (1,841+719,190+6,617), përbën detyrime të trashëguara nga bashkimi me ish komunat, por që nuk pranohen nga thesari, për shkak të mungesës së dokumentacionit.

<b>Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"</b>	
<b>Celje e vitit 2021</b>	<b>28,088,168</b>
<b>Gjendja në 31.12.2021 (K)</b>	<b>316,362,452</b>

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
<b>Llogari 401-409</b>	<b>28,978,777</b>
Detyrime për pagesë mat.elektrike	1,458,690
Detyrime për pagesë mat.disifektimi	595,200
Detyrime për pagesë mat.dokumentacioni	651,324
Detyrime për paisje zyre	687,798
Detyrime nga ish-komunat	21,045,765
Detyrime për pagesa te ndryshme	4,540,000

Shtesat në llogarinë 401-408, si rezultat i mbylljes së llogarisë 486 dhe 467, të cilat bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, kanë kaluar në llogarinë 85 ÷Rezultat i viti ushtrimorë. Në mënyrë analitike prekja e llogarive përkatëse (401-408) paraqitet si më poshtë:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Llog. Kontabel	Tipologjia e detyrimit	Balanca viti mëparshëm	Shtuar gjatë periudhës raportuese	Pakësuar gjatë periudhës raportuese	Balanca në fund të periudhës raportuese
4013100	Detyrime korrente per mallra dhe shërbime				
	Nga këto:				
	Të prapambetura për mallra	9,655,442		261,600	9,393,842
	Të prapambetura për shërbime	94,063,024	6,680,243		100,743,267
	Të prapambetura për mirembajtje e riparime	601,529			601,529
4043100	Të prapambetura për blerjen/krijimin e A.Qendrushme				
	Nga këto:te prapambetura Investime	82,016,486	976,274	6,197,916	76,794,844
4311300	Detyrime ndaj buxhetit te shtetit				-
	Nga këto:te prapambetura per tatimet mbi te ardhurat personale		1,841		1,841
	Nga keto te prapambetura per tatime te tjera		719,190		719,190
	Transferata tek individet				
4353100	Nga këto:te prapambetura per sigurime shoqerore		6,617		6,617
4363100	Nga këto:te prapambetura per sigurime shendetesore				
	Detyrime ndaj Institucioneve publike				-
4672100	Kreditore per vendime gjyqesore	118,877,527	38,683,011	57,710,345	99,850,193
		<b>305,214,008</b>	<b>47,067,176</b>	<b>64,169,861</b>	<b>288,111,323</b>

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Pogradec, paraqitet në vlerën 13,676,220 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 1,843,612 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë perkatsisht në vlerat 3,794,002 lekë dhe 517,003 lekë.

Detyrimet për paga, sigurime, tatime të muajit dhjetor 2021, të njohura si detyrim kundrejt shtetit janë në shumën 19,833,837 lekë, e cila duhet të rakordojë më llogarine 7206 ÷Financim i pritshëm nga buxheti, i cili paraqitet në shuëmn 19,106,189 lekë, me një diferencë prej 727,648 lekë (1,841+719,190+6,617), përbën detyrime të trashëguara nga bashkimi me ish komunat, por që nuk pranohen nga thesari, për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Llogaritë	Pasyra e pozicionit	Detyrime te prapambetura	Rregullimi	7206
	1	2	3=(1-2)	4
42	13,679,200			
431	1,843,612	721,031		
435	37,940,002	6,617		
436	517,003			
<b>Totali</b>	<b>19,833,837</b>	<b>(727,648)</b>	<b>19,106,189</b>	<b>19,106,189</b>

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Pogradec, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 31,257,016lekë dhe vlerën e pullave të gjendjes civile. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Pogradec, sipas aktrakordimit të konfirmuar me Shkresën nr. 32, datë 11.01.2022.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	34,172,488
Shtesa	31,257,016



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Pakësime	9,448,577
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>55,980,927</b>

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 9,724,727 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

<b>Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"</b>	
Celje e vitit 2021	302,387,489
Shtesa gjatë vitit	54,488,255
	356,875,744
Pakësime(kalon tek llog 401)sipas U/5-MFE	288,111,323
Pakësime gjatë vitit	59,039,694
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>9,724,727</b>

**Gjendja në fund = 9,724,727 lekë**

Shtesa gjatë vitit në mënyrë analitike;

1.Vendime Gjyqësore	45,683,790 lekë
2.Ndalesa Sindikata	420,300 lekë
3.Investime (Mbikqyrje)	976,274 lekë
4.Tatime	147,669 lekë
5.Sherbim mbetje(KRËM)	7,260,222 lekë
<b>Shuma</b>	<b>54,488,255lekë</b>

Pakësimet gjatë vitit në mënyrë analitike;

1.Vendime Gjyqësore	58,618,594 lekë
2.Ndalesa Sindikata	421,100 lekë
<b>Shuma</b>	<b>59,039,694 lekë</b>

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën (157,186,094) lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Pogradec trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

<b>Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"</b>	
Celje e vitit 2021	<b>149,595,704</b>
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>(157,186,094)</b>

<b>Llogari</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Shuma</b>
520	Disponibilitete në thesar	186,289,114
466	Mjete në ruajtje	(55,980,927)
63	Ndryshimi i gjendjes së inventarit	(-617042)
401-408	Detyrime të prapambeturaUdhëzimi nr. 5/2021	(288,111,323)
<b>85</b>	<b>Rezultati</b>	<b>(157,186,094)</b>

### **Pasqyra e Performancës financiare (F2)**

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Pogradec më datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Pogradec, konkretisht janë mbajtur Aktrakordimet e mëposhtme:

- Aktrakordimi nr. 94, datë 01.02.2022 òPër të ardhurat
- Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimetò
- Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga të ardhuratò
- Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga transfertat e pakushtëzuaraò



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEÇ**

- Aktrakordimi nr. 60, datë 06.01.2022 òPër shpenzimet nga transfertat e kushtëzuaraò
- Aktrakordimi nr. 32, datë 11.01.2022 òPër mjetet në ruajtje, llogaria 466ò

**Rakordimi të ardhurave**

	Emërtimi	Pasqyra e Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
I	-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit -Granti nga buxheti -Financim i pritshëm nga buxh. -Llog 73 Ndryshi i gjendjes me(+)	355,567,714 1,184,656,743 19,106,189	Aktrakordimi me Degën e Thesarit Sipas çeljes së buxhetit nga MFE Sipas llogarisë 7206 Aktrakordimi me Degën e Thesarit Nga rezultati i vitit të mëparshëm llog.85 Sipas llog 63 me (+)	355,567,714 1,184,656,743 19,106,189	
	<b>Totali të ardhura</b>	<b>1,559,330,646</b>	<b>Totali të ardhura</b>	<b>1,559,330,646</b>	<b>0</b>

**Rakordimi i shpenzimeve**

Llogaritë	Emërtimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
	<b>Total shpenzime</b>	<b>1,716,516,740</b>	<b>1,716,516,740</b>	
600	Pagat dhe perfitimet e punonjseve	198,077,531	198,077,531	
601	Kontribute te sigurimeve	34,733,019	34,733,019	
602	Blerje mallra e sherbime	452,537,123	452,537,123	
604	Transferime korente	1,031,222,078	1,031,222,078	
65	Shpenzime financiare	564,031	564,031	
63	Ndryshimi i gjendjes se inventarit	(617,042)	(617,042)	
<b>85</b>	<b>Rezultati i Veptrimarise se vitit Ushtrimor</b>	<b>(157,186,094)</b>	<b>(157,186,094)</b>	<b>0</b>

Sipas pasyrës së performancës financiare:

- Të ardhurat janë të barabarta me Shpenzimet, plus rezultatin e vitit ushtrimor  $1,559,330,646 = 1,716,516,740 + (157,186,094)$ .
- Të ardhurat nga taksat dhe tatimet janë të rakorduara sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit, për shumën 355,755,076 lekë.

**Pasqyra e flukseve monetare**

Pasqyra e Flukseve Monetare "Cashflo ", paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nga kontrolltet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 186,289,114 lekë dhe kuadron me tepriçën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën 186,289,114 lekë.

**Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)**

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 1,330,133,148 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

**Konkluzion:**

- Pasqyrat financiare të vitit 2021, janë hartuar në sipas formatit të miratuar dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, me ndryshime. Ato përbëhen nga Pasqyrat e Pozicionit financiar, Performancës Financiare, Lëvizjes së mjeteve monetare, Aktivet/fondet neto si dhe Relacionin shpjegues. Pjesë e tyre janë edhe Pasqyrat statistikore. Pasqyrat financiare të vitit 2021, paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashiksë Pogradec më 31.12.2021, përveç dy çështjeve të cilat kanë të bëjnë me aktivet, dhe detyrimet, konkretisht:



1. Kontabilizimi i aktiveve nuk është i mbështetur në të gjitha rastet me dokumentacion autorizues (titull pronësie). Nuk është kryer për të gjitha aktivet të cilat janë në inventarin e Bashkisë Pogradec, një pjesë e tyre nuk është e pajisur me çertifikatë pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Nga auditimi ka rezultuar se ka aktive, të cilat nuk janë të përfshira në kontabilitet për faktin se nuk janë të pasqyruar në vlerë, si rrjedhojë e bashkimit të NJSH, dhe përcjelljes së pronave pa një inventar në sasi dhe vlerë. **Sipas të dhënave nga 2,672 asete të listuara, vetëm 109 prona janë të regjistruara, si dhe nga këto vetëm 31 janë të pajisura me titull pronësie.**
2. Gjendja në fund e detyrimeve debitorë nuk janë pasqyruar drejtë në kontabilitet. Detyrimet e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore janë dërguar nga ana e drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore me shkresë nr.1837 prot, datë 13.04.2022. Informacioni mbi subjektet debitorë për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2021, Drejtorisë ekonomike dhe menaxhimit financiar, por rezulton se nga Drejtoria ekonomike nuk është vepruar për kontabilizimin e tyre. Për rrjedhojë nuk është pasqyruar në bilanc për vitin 2021, vlera e debitorëve për **57,139,720 lekë**. Pra debitorët sipas Bilancit janë më pak se të dhënat e Zyrës së Tatimit Taksave në fund të vitit 2021 për shumën **57,139,720 lekë**.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 3 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 5 datë 20.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 1690/8, datë 20.05.2022 dhe trajtuar hollësisht në PRA. Mbi këtë drejtim të trajtuar në PRA nuk janë paraqitur observacione.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** zj. I.K, Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar dhe Nëpunëse Zbatuese.

#### **II.2.4. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

##### *Auditimi i fundit në Bashkinë Pogradec*

Auditimi i fundit në Bashkinë Pogradec është kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2020, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 102/35 prot., datë 19.07.2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 30 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 6 masa për shpërblim dëmi;
- 1 masë për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike;
- 1 rekomandim për masa disiplinore, ku vetë subjekti ka caktuar masa për 23 punonjës.

#### **1. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.**

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, germa j për Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit, Bashkia Pogradec për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 102/35 prot., datë 19.07.2021, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 102/36 Prot, datë 09.08.2021, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Bashkia Pogradec ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.





**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.**

Rezulton se nga Bashkia Pogradec me shkresën nr. 355/67 Prot, datë 06.08.2021 është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2, *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*. Raportimi 6 muhor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve është dërguar në KLSH brenda afateve ligjore.

**3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të KLSH**

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Pogradeca hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 353/66 prot., datë 05.08.2021 dhe ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 50, pika 5, *“Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”*.

Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së rezulton se, pjesa më e madhe e çështjeve që adresojnë këto rekomandime janë si vijon, 17 në proces zbatimi, 16 janë zbatuar dhe vetëm 5 rekomandime janë të pa zbatuara.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se janë rekomanduar dhe pranuar gjithsej:

30 masa organizative; 5 pa zbatuar; 13 zbatuar; dhe 12 në proces zbatimi,

6 masa shpërblim dëmi; 1 zbatuar; dhe 5 në proces zbatimi,

23 masa disiplinore, të vendosura nga vetë subjekti,

1 masë për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike, e cila është zbatuar.

***Shënim: Në mënyrë analitike zbatimi i tyre paraqitet në pasqyrat anekse të Projekt Raportit të Auditimit.***

**Titulli i gjetjes 18: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të KLSH.**

**Situata:** Meshkresën nr. 102/35 prot., datë 19.07.2021, KLSH ka dërguar në Bashkinë Pogradec Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezulton se:

***Rekomandimi 1.1 është i pazbatuar.***

- Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, për vitin 2021.
- Pavarësisht kryerjes së mbledhjeve të GMS, nuk ka të evidentuar vendime në formë shkresore, që vijnë si rezultat i çështjeve që janë diskutuar në këto mbledhje. Gjithashtu nuk kanë të evidentuar as masat e ndërmarra për çështjet kryesorë të diskutuara, nisur nga procesverbalet e mbajtura për këto takime.
- Në Bashkinë Pogradec nuk ka një urdhër për hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditit.



- Në Bashkinë Pogradec është hartuar vetëm gjurma e auditit për prokurimet me vlerë mbi 1.000.000 lekë pa TVSH, referuar shkresës, nr. 5795 prot., datë 14.12.2021 dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec.
- Gjurma e Auditit për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA dhe Gjurma e Auditit për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë pa TVSH, nuk janë hartuar dhe si rrjedhim nuk figurojnë si dokument në Bashkinë Pogradec.
- Çfarë evidentohet nga praktika, punonjësit përdorin më tepër postën elektronike personale, ndërkohë që duhet bërë e mundur që të mund të përdorin postën elektronike të Bashkisë për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.
- Në Bashkinë Pogradec Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk ka hartuar dhe miratuar një program trajnimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, si dhe nuk ka të planifikuar fonde të dedikuara për trajnimin e punonjësve, për vitin 2021.

***Rekomandimi 2.2 është i pazbatuar.***

Përsa i takon trajnimeve periodike, që duhet të realizojë stafi i audituesve që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Pogradec vihet re se nuk është hartuar një Plan i Zhvillimit Profesional të nëpunësve duke planifikuar marrjen pjesë të tyre rregullisht në trajnimet e ofruara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) apo ASPA dhe nuk janë ndjekur trajnime të vijueshme profesionale për vitin 2021.

***Rekomandimi 3.1 është i pazbatuar.***

Nuk kanë realizuar një planifikim në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme të buxhetit përsa i takon shpenzimeve, pasi parashikimi është bërë në vlera të larta ndërkohë që ka diferenca të mëdha krahasuar me realizimin.

***Rekomandimi 9.1 është i pazbatuar.***

Policia Bashkiake nuk ka gjetur mekanizma ligjore për të vendosur gjobat te fatura e ujit për subjekte të ndryshme.

***Rekomandimi 21.1 është i pazbatuar.***

Policia Bashkiake nuk ka gjetur mekanizma ligjorë për të vendosur gjobat te fatura e ujit për subjekte të ndryshme

**Kriteri:**

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, germa 30 dhe neni 30 pika 2.

**Impakti:**

Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Pogradec ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit.

**Shkaku:**

Procesi është duke u ndjekur në rrugë ligjore për një pjesë të operatorëve dhe bashkim operatorësh, ndërsa për mbikëqyrësit e punimeve është bërë vetëm njoftim për arkëtimin e detyrimit.

**Rëndësia:**

**E lartë**

**Rekomandimi:**

Rikërkim i zbatimit të rekomandimeve të pazbatuara.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI FINANCIAR NË BASHKINË POGRADEC**

Lloji i rekomandimeve	Rekomandi me të dhëna	Pranuar				Pa pranuar
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	
Masa organizative	30	13	-	12	5	0
Masa shpërblim dëmi	6	1	-	5	-	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	1	1	-	-	-	0
Masa disiplinore (sipas tabelës anekse nr. II.2.4.1	23	23	-	-	-	0

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.4 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktverifikimi nr. 1 datë 06.05.2022, protokolluar në Bashkinë Pogradec me protokoll nr. 1690/9 datë 20.05.2022. Mbi këtë drejtim të trajtuar në PRA, nuk janë paraqitur observacione.**

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Pogradec dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit 2021 ka pësuar ndryshime, duke shtuar dhe pakësuar vlerat e disa llogarive, sipas nevojave të Bashkisë Pogradec. Gjithashtu, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Kështu janë kryer 7 ndryshime me vlerë 219,798 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit të buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, në bashkëpunim Sektorët e tjerë në Bashkinë Pogradec, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit korent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se realizmi i investimeve të planifikuara për vitin 2021 është në shumën 183,758 mijë lekë, nga 338,900 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 54% kundrejt planit.

Kjo situatë është rrjedhojë e planifikimit të procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime që bien ndesh me disiplinën buxhetore, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/ blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 60% për asnjërin nga vitet objekt auditimi. Gjithashtu,



bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), gjë e cila nuk mbahet në konsideratë gjatë hartimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, që në fund të vitit 2021 rezultojnë në shumën 316,431 mijë lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të viteve paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

**2.2. Rekomandimi:** Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikuiduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbime dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Pogradec.

**2.3. Rekomandimi:** Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave mbi pagesat e kryera, është konstatuar se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime për shërbime dhe investime të mbërritura në institucion.

Nga Bashkia Pogradec (Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, kjo për efekt të mungesës së fondeve nga mos realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2021, paraqiten gjithsej 3 fatura në tejkalim afatesh, me vlerëntotale 84,317 mijëlekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijë kufizime limiti të arkës (*përfshirë kufizimet e MFE*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të pa likuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Pogradec nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore. Nga verifikimi i të dhënave, konstatohet se fondet e akorduara nga ministritë e linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Pogradec për vitin 2021 dhe granteve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë.

**Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Pogradec (Sektori i buxhetit), nuk merr në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 60%, nuk ka në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të larta.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*



**4.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

**4.2. Rekomandimi:** Planifikimi i të ardhurave të kryhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

**4.3. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pogradec për vitin 2021, ka planifikuar të ardhurat e veta në vlera jo reale dhe të pa argumentuara, ka një rritje artificiale të planit të të ardhurave fenomen që vihet re edhe nga realizimi i tyre në nivele jo të mira.

Nisur nga ky fenomen gjatë planifikimit të buxhetit vjetor 2021, Bashkia Pogradec ka planifikuar të kryejë shpenzime kapitale dhe korente bazuar mbi transfertën e pakushtëzuar dhe planit të të ardhurave të veta jo real. Për rrjedhojë bashkia ekspozohet kundrejt dy fenomeneve si, përqindje shumë e ulët e realizimit të investimeve të planifikuara, pasi fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (transferta e pakushtëzuar), përdoret për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimeve në masën rreth 30% duke qenë se në Bashkinë Pogradec rezulton një strukturë e organikës me numër të lartë punonjësish, tendencë kjo që ka ardhur në rritje nga viti në vit dhe marrja e angazhimeve tej mundësive reale, krijon premisa për mos shlyerje të tyre në kohë dhe masën e duhur të detyrimeve, duke e vënë Bashkinë në vështirësi financiare, për shkak të mungesës së likuiditeteve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Nga ana e Titullarit të Bashkisë Pogradec, të merren masa për rishikimin e strukturës së punonjësve me qëllim eliminimin e strukturave të panevojshme, uljen e numrit të punonjësve dhe për rrjedhojë uljen e shpenzimeve për paga, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Pogradec.

**5.2. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit dhe Kontabilitetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi të ardhurat e bashkisë, të mbështetet në një plan real, në marrjen e angazhimeve buxhetore, të cilat prekin edhe periudhat e ardhshme buxhetore dhe bëhen shkas për krijimin e situatave të vështira financiare dhe për rrjedhojë mos financim në masën dhe kohën e duhur të këtyre angazhimeve.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec, nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe in produktive, në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Pogradec, nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është 440,000 lekë/ha/vit në territor toke In produktive.





*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 23-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Pyjor, të marrin masa të ngrihet grup pune për të kryer verifikimin në terren të subjekteve të cilat janë pajisur me leje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Pogradec.

**6.2. Rekomandimi:** Për këto subjekte të evidentuara zona e lejuar e shfrytëzimit të hiqet nga fondi pyjor dhe kullësor dhe të kalojë si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës.

**6.3. Rekomandimi:** Deri në momentin e heqjes nga fondi pyjor i Bashkisë Pogradec, të merren masa për të lidhur kontratat me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shfrytëzimit me karrierë të mineraleve ndërtimore.

**Afati 3 muaj.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2021, ka rezultuar se llogaria 468 ÷Debitorë të ndryshëmë paraqitet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në shumën **57,139,720 lekë më pak**. Nga rakordimi i të dhënave mbi detyrimet debitorë nga subjektet, ndaj Bashkisë Pogradec me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka rezultuar se këto detyrime janë në shumën 59,397,820 lekë. Sipas të dhënave analitike të llogarisë 468 ÷Debitorë të ndryshëmë, rezulton se në fund të vitit 2021, debitorët nga tatim taksat lokale paraqiten në shumën 2,258,100 lekë, nga 59,397,820 lekë që janë të evidentuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Pra debitorët sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar rezultojnë të jenë regjistruar më pak për shumën 57,139,720 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me parimet e kontabilitetit dhe përcaktimet në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 50-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për të kryer rakordim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me detyrimet debitorë të lindura nga mos pagesat e taksave dhe tarifave vendore dhe të pa kontabilizuara për shumën 57,139,720 lekë, si dhe të kryej kontabilizimin e tyre, pas rakordimit, me qëllim paraqitjen e drejtë të kësaj llogarie (468 ÷Debitorë të ndryshëmë) në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

**Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidentimin, inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve në kontabilitet ka rezultuar se, objektet inventar të pasurive të paluajtshme, përgjithësisht nuk janë të regjistruar në regjistrat shtetërorë të pasurive të paluajtshme (ASHK) ose janë të regjistruar, por nuk janë të pajisur me certifikatë pronësie. Konkretisht të dhënat paraqiten në tabelën nr. 17.1, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, sipas të cilës nga 2,672 asete të inventarizuara nga Sektori i menaxhimit të aseteve të Bashkisë Pogradec, vetëm 109 prej tyre janë të regjistruara, si dhe nga këto vetëm 31 janë të pajisura me titull pronësie. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Këto veprime mbi mënyrën e regjistrimit të aseteve në kontabilitet, janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme ÷ ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme



pika 2.1 òParimet e kontabilitetit në sektorin publikò dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò pika 35.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 50-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Pogradec, duhet të marrë masa për analizimin e situatës, përlllogaritjen e kostos për realizimin e këtij shërbimi, planifikimin në buxhet, si dhe nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së, të pasurive të paluajtshme, në emër të Bashkisë Pogradec.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe mbi vlerësimin e komponentëve të këtij sistemi si, Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i riskut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe Monitorimi, janë evidentuar veprime dhe mosveprime, të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 8, germa a; neni 27, pika 1; neni 9, pika 2; neni 16, pika 2 dhe 3, si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar një strategji për menaxhimin e riskut për periudhën objekt auditimi, e cila do shërbente si një qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e kreut të administratës dhe do ishte e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

- Në Bashkinë Pogradec pavarësisht kryerjes së mbledhjeve të GMS për vitin 2021, nuk ka të evidentuara vendime në formë shkresore, që vijnë si rezultat i çështjeve më problematike që janë diskutuar në këto mbledhje.

- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i cili paraqet të gjitha llojet e monitorimit dhe vlerësimin të sistemit të MFK-së, duke ndihmuar në identifikimin dobësive dhe mangësive e rrjedhimisht dhe identifikimin e masave dhe aktiviteteve për t'ia korrigjuar ato. Këto faza janë pikënisja për planifikimin e aktiviteteve që synojnë ngritjen dhe zhvillimin e MFK-së.

- Në Bashkinë Pogradec nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave, mungesa e të cilit pengon identifikimin e hapave që do të ndërmerren për të arritur objektivat e njësisë publike dhe për minimizimin e risqeve apo mangësive.

- Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është hartuar gjurma e auditit për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA dhe gjurma e auditit për prokurimet me vlerë nën 1.000.000 lekë pa TVSH, për procese kryesore të veprimtarisë si vjelja e të ardhurave, ndjekja e debitorëve, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 49-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1. Rekomandimi:** Titullari i Institucionit, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësi Zbatues, si dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me qëllim funksionimin sa më të plotë të komponentëve të MFK-së, duhet:

- të marrin masa që të rishikojë dhe rivlerësojë në mënyrë periodike Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, e cila ndihmon në specifikimin në mënyrë të detajuar të trajtimit të risqeve në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti.

- të marrin masa që temat më problematike, të cilat lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, jo vetëm të diskutohen gjatë takimeve periodike të realizuara nga GMS ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik, por edhe të dokumentohen vendimet e marra për diskutimet përkatëse.



- të marrin masa që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në mënyrë që të jetë i mundur identifikimi i dobësive dhe mangësive, duke ndërmarrë edhe masat e duhura për t'i korrigjuar ato në vazhdimësi.
- të marrin masa që të hartojë çdo vit Planin e Veprimit për arritjen e objektivave, duke përcaktuar afatet dhe strukturat përgjegjëse me qëllim realizimin dhe përmbushjen e tyre në kohë.
- të marrin masa që të hartojë gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës, në mënyrë që të garantohet ecuria e aktiviteteve të këtyre proceseve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pogradec nuk është planifikuar një program trajnimi dhe nuk janë organizuar trajnime për audituesit që janë pjesë e Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2021. Veprimi i mësipërmështë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 20, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 8-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pogradec, duhet të marrë masa për realizimin e trajnimeve profesionale të rregullta për stafin që është pjesë e kësaj njësie, në mënyrë që të rritet zhvillimi i aftësive profesionale të tyre në fushën e auditimit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Pogradec nuk ka dërguar Kartën e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 14, germa (b).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 8-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që Karta e Auditimit si një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.

**Deri më datë 31.12.2022**

**12. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pogradec nuk ka hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm, për vitin 2021, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 7.1.1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 8-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Pogradec, duhet të hartojë në mënyrë periodike Programin e Sigurimit të Cilësisë të Njesisë, për atë kohë sa ai shërben si një mjet apo tregues për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm të njësisë publike.

**Deri më datë 31.12.2022**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, ka rezultuar se:

- Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 30 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 30 masa, janë zbatuar plotësisht 13 masa; janë në proces zbatimi 12 masa dhe **janë pa zbatuar 5 masa.**



